



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.90

15 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.41, datë 24.6.2010	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	4597
Vendim i KM nr.457, datë 16.6.2010	Për një shtesë në vendimin nr.1290, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”	4598
Vendim i KM nr.459, datë 16.6.2010	Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS	4598
Vendim i KM nr.460, datë 16.6.2010	Për organizimin dhe funksionimin e Regjistrit të Planifikimit të Territorit	4609
Udhëzim i KM nr.5, datë 30.6.2010	Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën e renditjes së punëve në shërbimin civil, metodologjinë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të sekretarit të përgjithshëm në këtë shërbim”, të ndryshuar	4615
Udhëzim i përbashkët i METE dhe MF nr.4489, datë 6.5.2010	Për furnizimin nga rafineritë dhe shoqëritë e tregimit me shumicë të lëndës djegëse që nuk përdoret për automjete rrugore dhe gjeneratorë	4615
Udhëzim i MB nr.212, datë 28.6.2010	Për marrjen dhe bashkërendimin e masave për garantimin e rendit dhe rritjen e sigurisë publike, gjatë sezonit turistik veror 2010	4616

Udhëzim i përbashkët i MPPT dhe MF nr.13, datë 15.6.2010	Mbi disa ndryshime e shtesa në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar	4619
Udhëzim i MF nr.20, datë 23.6.2010	Për mënyrën e llogaritjes së detyrimeve tatimore për kategoritë e lojëave “Baste sportive” dhe “Bingo”	4625
Udhëzim i MF nr.21, datë 23.6.2010	Për kriteret, mënyrën, masën dhe formën e dëmshpërblimit për shoqëritë të cilave u është revokuar licenca për lojëra fati	4626
Urdhër i përbashkët i METE dhe MF nr.4288, datë 30.4.2010	Për kontrollin cilësor dhe sasior të nënprodukteve të naftës dhe lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, të prodhuara në rafineritë e naftës dhe në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme në Republikën e Shqipërisë	4627

VENDIM
Nr.41, datë 24.6.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 58 pika 2 hiqen fjalët “për emërim dhe shkarkim ministri”.

Neni 2

Në nenin 60, para pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në rastin e dhënies së pëlqimit të Kuvendit për dekretet e Presidentit të Republikës për emërim në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë votimi është nominal.”.

Neni 3

Në nenin 111 pika 6 fjalët “brenda tre javëve” ndryshohen në “brenda 8 javëve”.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.457, datë 16.6.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1290, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 3 të vendimit nr.1290, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të bëhet shtesa e mëposhtme:

- PAGESA ME 5000 (PESË MIJË) LEKË PËR KOKË, PËR FERMAT BLEGTORALE QË MBARËSHTOJNË MBI 10 KRERË NJËTHUNDRAKË, POR JO MË SHUMË SE PËR 30 KRERË.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.459, datë 16.6.2010

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË PËRBASHKËTA GJEODEZIKE DHE GIS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 55 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregullat për zbatimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), që duhen përdorur nga autoritetet e planifikimit të territorit dhe institucione të tjera publike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Standardet e përgjithshme gjeodezike dhe të Sistemit të Informacionit Gjeografik përcaktojnë:

a) mënyrën se si përshkruhet përmbajtja dhe struktura e të dhënave hapësinore, në mënyrë formale dhe të qartë, dhe si të përftohet nga ky përshkrim një format/sistem i pavarur për shkëmbimin e të dhënave;

b) metadatat që duhen mirëmbajtur për të dhënat hapësinore dhe shërbimet e zbulimit, të shikimit e të shkarkimit të të dhënave hapësinore, nëpërmjet një portali web në internet.

Zbatimi i këtyre standardeve lehtëson ndarjen e të dhënave dhe rrit ndërveprimin ndërmjet të gjitha palëve që administrojnë informacion hapësinor.

3. Këto standarde janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha autoritetet kombëtare e vendore, përgjegjëse për mbajtjen e informacionit në lidhje me planifikimin e territorit në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të detyruara të shkëmbejnë e të shpërndajnë informacionin hapësinor nëpërmjet Regjistrit të Planifikimit të Territorit, të përcaktuar në kapitullin V të ligjit

nr.10110, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Të gjithë personat, të cilët shkëmbejnë të dhëna nëpërmjet Regjistrit të Planifikimit të Territorit, janë të detyruar të veprojnë në përputhje me këto standarde.

4. Regjistrimi i të dhënave dhe i metadatave (ose të dhënat mbi të dhënat) organizohet sipas një rrjeti të integruar dhe shumëqëllimësh bazash elektronike kadastrale, të pavaruara e ndërvepruese ndërmjet tyre.

5. Rregullat e parashikuara në këtë vendim shërbejnë si bazë për krijimin dhe organizimin e portalit web të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, si dhe për përcaktimin nga autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë, të standardeve për shkëmbimin e informacionit nëpërmjet këtij portali.

6. Të dhënat dhe metadat, që regjistrohen në portalin web të Regjistrit, krijohen në mënyrë të pavarur nga autoritetet e planifikimit të territorit, në përputhje me standardet e parashikuara në këtë vendim.

7. Të dhënat dhe metadat shkëmbehen sipas standardeve të parashikuara në këtë vendim për transferimin e shkëmbimin e tyre ndërmjet sistemeve të ndryshme të informacionit, si dhe për lejimin e çdo subjekti të interesuar për marrjen ose përdorimin e tyre.

8. Të dhënat dhe metadat, të përfuara sipas standardeve, duhet të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

9. Standardet e përbashkëta gjeodezike dhe GIS sigurojnë bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, institucioneve të tjera publike e personave juridikë.

10. Standardet e përbashkëta gjeodezike dhe GIS, si standarde ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO), janë të detyrueshme për zbatim sipas këtij vendimi në masë të plotë, për aq sa parashikimet e tyre nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

11. Standardet e parashikuara në këtë vendim për krijimin e të dhënave dhe të metadatave shërbejnë si burim kryesor për autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë që mirëmbajnë informacion hapësinor. Këto standarde realizojnë:

- a) lexueshmërinë e të dhënave nëpërmjet mjeteve të komunikimeve elektronike;
- b) shmangien e regjistrimit të të dhënave të panevojshme dhe që nuk kanë lidhje me bazën e të dhënave;
- c) kuptimin e përgjithshëm të të dhënave dhe të metadatave, si dhe gjetjen e informacionit për të dhënat që kërkohen.

12. Standardet e parashikuara në këtë vendim ndahen në tri grupe:

- a) Standarde për specifikimin e të dhënave dhe të metadatave;
- b) Standarde për përshkrimin e formatimit dhe të kodimit të të dhënave;
- c) Standarde për përcaktimin e shërbimeve të rrjetit.

II. STANDARDET PËR SPECIFIKIMIN E TË DHËNAVE DHE TË METADATAVE

1. Këto standarde përshkruajnë se si autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike e personat juridikë përcaktojnë, në mënyrë formale dhe të qartë, të dhënat dhe *metadat*, me anë të zbatimit të modelimit konceptual. Në specifikimin e të dhënave e të *metadatave*, i cili bëhet sipas standardeve të parashikuara në këtë vendim, përfshihen edhe karakteristikat e tyre hapësinore dhe kohore.

2. Standardet për specifikimin e të dhënave të dokumenteve përfshijnë:

- a) modelin e referencës (ISO 19101);
- b) skemën e konceptimit të gjuhës (ISO 19103);
- c) skemën hapësinore (ISO 19107);
- ç) skemën e përkohshme (ISO 19108);
- d) rregullat për skemën e aplikimit (ISO 19109);
- dh) referimin hapësinor me koordinata (ISO 19111);
- e) informacionin gjeografik për metadata (ISO 19 115);

ë) projekSIONET europiane të hartave (EUR 20120).

3. Modeli i referencës. Ky standard përcakton modelin e referencës që përshkruan të gjitha kërkesat për standardizimin dhe parimet themelore që zbatohen për zhvillimin e përdorimin e standardeve për informacionin gjeografik. Ky standard shërben si bazë për standardet e tjera, të parashikuara në këtë kre, si dhe për standardet e parashikura në kërret III dhe IV të këtij vendimi.

4. Skema konceptuale e gjuhës. Ky standard përcakton skemën konceptuale të gjuhës që përdoret për zhvillimin e skemave (modeleve) elektronike të përkthyeshme, të informacionit gjeografik. Këto skema shërbejnë si bazë për shkëmbimin e të dhënave dhe për përcaktimin e shërbimeve të ndërveprimit. Standardet identifikojnë kombinimin e kategorisë së diagramës së modelit të njehsuar të gjuhës (MNjGj) me kufizimin e objektit të gjuhës (KOGj), që bashkëshoqërohet me të, si dhe një grup përkufizimesh bazë, si skema konceptuale e gjuhës për specifikimin e informacionit gjeografik.

5. Skema hapësinore. Ky standard parashikon skemat konceptuale për përshkrimin dhe përdorimin e karakteristikave hapësinore të tipareve gjeografike me një tipar gjeografik, që është një prezantim abstrakt i një dukurie reale të botës, të shoqëruar me vendndodhje relative në tokë. Ky standard përmban të dhëna vektor (të vektorizuara) që shprehin karakteristikat e tyre hapësinore të tipareve gjeografike.

6. Skema e përkohshme. Ky standard përcakton kërkesat për përshkrimin e karakteristikave të përkohshme të informacionit gjeografik.

7. Rregullat për skemën e aplikimit. Ky standard përcakton mënyrën se si përshkruhen përmbajtja dhe struktura e të dhënave, në mënyrë formale e të qartë, nëpërmjet një skeme aplikimi. Një skemë aplikimi parashikon:

a) një dokumentim të plotë të të dhënave në një fushë të veçantë ose fushë aplikimi (p.sh. zyrë urbanistike, kadastër etj.);

b) përshkrimin e të dhënave të lexueshme, në mënyrë elektronike, që bëjnë të mundur zbatimin e mekanizmave automatike për administrimin e të dhënave.

Nëpërmjet përdorimit të një skeme aplikimi arrihet një kuptim i përbashkët dhe i saktë i të dhënave në një fushë të caktuar të zbatimit të tyre.

Standardet përcaktojnë vetëm mënyrën se si duhet të përshkruhet përmbajtja dhe struktura e të dhënave, kur nuk përcaktohet struktura e përmbajtja në vetvete. Përcaktimi i përmbajtjes dhe i strukturës së të dhënave në një fushë të caktuar zbatimi është një proces miratimi, ku përfshihen të gjitha palët që do të mirëmbajnë e ndajnë së bashku të dhënat e kësaj fushe zbatimi.

8. Referimi hapësinor me koordinata. Informacioni gjeografik përmban referenca hapësinore që lidhen me karakteristikat në një vendndodhje relative në tokë. Kjo referencë hapësinore mund të vendoset nëpërmjet përdorimit të koordinatave ose të identifikuesve gjeografikë. Ky standard përfshin dhënien e referencave duke përdorur koordinatat. Koordinatat janë të qarta vetëm kur sistemi i referimit koordinativ, me të cilin janë të lidhura ato koordinata, përcaktohet plotësisht. Ky standard përshkruan elementet e nevojshme për përcaktimin e plotë të sistemeve të referimit koordinativ që zbatohen për informacionin gjeografik, si dhe përcakton transformimin ose konvertimin e koordinatave midis dy sistemeve të ndryshme të referimit koordinativ.

9. Informacioni gjeografik për metadat. Ky standard përcakton metadat që mirëmbahen për të dhënat hapësinore dhe shërbimet e të dhënave hapësinore. Përkufizimi i një grupi elementesh të metadateve është i nevojshëm për të lejuar:

a) identifikimin e burimit të informacionit, për të cilin metadat krijohen;

b) klasifikimin e burimit dhe identifikimin e vendndodhjes së tij gjeografike e të referencës hapësinore;

c) cilësinë dhe vlefshmërinë;

ç) përputhshmërinë me rregullat e zbatueshme për ndërveprimin e grupit të të dhënave hapësinore e të shërbimeve;

d) kufizimet mbi aksesin e përdorimin;

dh) organizimin e elementeve të lidhura me origjinën.

Elementet e *metadatave* të lidhura me regjistrimin e vetë *metadatave* janë të nevojshme për monitorimin, në mënyrë që *metadatave* të krijuara të mbahen të përditësuara, si dhe për identifikimin e autoritetit përgjegjës për krijimin e mirëmbajtjen e tyre. Grupi (numri dhe përshkrimi) minimal i elementeve të *metadatave* që duhen mirëmbajtur për të dhënat e shërbimet e parashikuara në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, përcaktohet në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Kjo nuk përjashton mundësinë që grupet e interesit, në përputhje me parashikimet e Regjistrin të Planifikimit të Territorit, të dokumentojnë burimet e informacionit, më gjerësisht, me elemente shtesë, që rrjedhin nga standardet ndërkombëtare ose praktikatat e hasura gjatë punës, në fushën e tyre të zbatimit.

10. Projektionet europiane të hartave. Ky standard përcakton sistemet e referimit hapësinor të koordinatave dhe sistemet vertikale të referimit që do të përdoren për informacionin gjeografik, të administruar e të mirëmbajtur në Regjistrin e Planifikimit të Territorit. Sipas këtij standardi, sistemi i Referencës Tokësore Europiane (ETRS-TMzn) ETRS89 do të përdoret për të gjitha hartat në një shkallë më të madhe se 1:500 000. Sistemi ETRS80 Lambert Conformal Conic Projection (ETRS-LCC) do të përdoret për hartat me shkallë të njëjtë ose më të vogël se 1:500 000.

III. STANDARDET PËR PËRSHKRIMIN E FORMATIT DHE TË KODIMIT TË TË DHËNAVE

1. Standardet e parashikuara në këtë seksion përcaktojnë formatin e të dhënave që ndahen dhe shkëmbehen ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, institucioneve të tjera publike e personave juridikë. Këto standarde përcaktojnë rregullat e kodimit, duke përshkruar se si skema për një format të transferimit të të dhënave për një sistem të pavarur mund të rrjedhë nga një skemë aplikimi.

2. Këto standarde të përshkruara në këtë kre përfshijnë:

- a) kodimin (ISO 19115);
- b) gjuhën e etiketimit gjeografik (ISO 19136);
- c) metadatën – kodimin XML (ISO 19139).

Standardet në veçanti i përkasin shitësve të programeve kompjuterike (software) që duhet të ofrojnë aplikime, të cilat mund të lexojnë e shkruajnë formate që nevojiten për ndarjen dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, institucioneve të tjera publike dhe personave juridikë.

3. Kodimi. Ky standard specifikon kërkesat për përcaktimin e rregullave të kodimit që përdoren për shkëmbimin e të dhënave gjeografike ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, institucioneve të tjera publike dhe personave juridikë. Një rregull kodimi lejon informacionin gjeografik të përcaktuar nga skema aplikimi dhe skema të standardizuara për kodim në një strukturë të dhënash të një sistemi të pavarur për transferim ose depozitim.

4. Gjuha e etiketimit gjeografik (GML). Gjuha e etiketimit gjeografik (GML) është kodimi XML sipas standardeve të përshkruara në pikën 3 të këtij kreu, për transferimin dhe depozitimin e informacionit gjeografik, të modeluar sipas kuadrit të modelimit konceptual, të përdorur në seritë 19100 të standardeve ISO të Standardeve Ndërkombëtare dhe që përfshin regjistrimet hapësinore e jhapësinore për karakteristikat gjeografike të tokës. Standardi GML është kodimi më i parapëlqyer për t'u përdorur kur informacioni gjeografik shkëmbehet ndërmjet autoriteteve të planifikimit. Nëse një skemë aplikimi e përshkruar në URL përdoret si bazë për ruajtjen e transferimin e informacionit gjeografik dhe sipas standardeve ISO 19109 (Pika 3, në kreun II të këtij vendimi), standardet në GML parashikojnë rregulla normative për planifikimin e kësaj skeme aplikimi në një skemë aplikimi GML në skemën XML dhe, si e tillë, në një kodim XML të të dhënave me një strukturë logjike, në përputhje me skemën e aplikimit të pajtueshme ISO 19109.

IV. STANDARDE PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË RRJETIT

1. Hyrja në bazën e të dhënave dhe të metadatave, që mbahen nga çdo autoritet i planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të rrjetit të informacionit të ofruar.

2. Do të ofrohen tri lloje shërbimesh:
 - a) Shërbimi i kërkimit dhe i gjetjes së informacionit;
 - b) Shërbimi i shikimit të tyre;
 - c) Shërbimi i shkarkimit të informacionit.

Standardet, që mbulojnë shërbimet në rrjetin e informacionit, përcaktojnë sintaksën dhe përmbajtjen e kërkesave që një shërbim është në gjendje të kuptojë, si dhe sintaksën dhe përmbajtjen e përgjigjeve.

3. Shërbimet e shikimit dhe të shkarkimit të informacionit përdoren në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.3.2007 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Këto shërbime sigurojnë mbrojtjen e akteve që klasifikohen konfidenciale ose sekret shtetëror në përputhje me ligjin nr.8547, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

4. Shërbimi i kërkimit dhe i gjetjes së informacionit.

Ky shërbim përdoret për të kërkuar/për të gjetur të dhëna nëpërmjet një grupi kriteresh kërkimore, të cilat do të jenë bërthama e elementeve metadata nga ISO 19115 (Metadata për informacion gjeografik).

Specifikimi i shërbimit të gjetjes së informacionit është Katalogu i Shërbimeve OGC për Specifikimin e Rrjetit.

5. Shërbimi i shikimit. Ky shërbim përdoret për të përfutur pamjen e hartës së ofruar si imazh ose format grafik dhe krijohet nga një a disa të dhëna hapësinore. Nuk ka shërbim shikimi të përcaktuar për të dhëna johapësinore. Specifikimi i shërbimit të shikimit është Shërbimi i Hartës Web (SHHW) të përshkruar hollësisht në standardin ISO 19128, ndërsa portretizimi i informacionit gjeografik (simbole kartografike etj.) rregullohet nga ISO 19117.

6. Shërbimi i shkarkimit të informacionit. Ky shërbim përdoret për të përfutur të dhëna dhe mund të ndahet në dy kategori kryesore:

- a) Shërbime shkarkimi për mbledhje të dhënash ose pjesë të tyre të paracaktuara;
- b) Shërbime shkarkimi me hyrje të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe mundësinë e marrjes së informacionit për të dhënat.

6.1. Për të përdorur kategorinë e parë të shërbimit të shkarkimit, duhen *metadata* për mbledhjen e të dhënave, të paracaktuara, që përmban URL ku baza e të dhënave ose pjesë të saj mund të shkarkohen menjëherë me një kërkesë të thjeshtë HTTP. Një bazë të dhënash e paracaktuar ose pjesë të saj të paracaktuara përfaqësojnë në koncept, një dosje të ruajtur në ruajtësin e bazës së të dhënave, që mund të shkarkohet si një njësi e tërë pa pasur asnjë mundësi për t’u ndryshuar përmbajtja. Kjo gjë lejon zgjidhjen më të thjeshtë teknike për sigurimin e hyrjes në bazën e të dhënave.

6.2. Kategoria e dytë e shërbimit të shkarkimit lejon më tepër kontroll gjatë shkarkimit. Nuk është e detyrueshme, por gjithsesi, nëse sigurohet, duhet të zbatohet si shërbim rrjeti siç përcaktohet në ISO 19142, me kërkesën e pajisjes së filtrit të kodimit(FK) po sipas përcaktimeve të ISO 19143. Në këtë rast, informacioni hapësinor ruhet në mënyrë tipike në ruajtësin e informacionit (p.sh. në bazën e të dhënave) dhe në të mund të depërtohet vetëm nëpërmjet sistemit të bazës së të dhënave. Hyrja drejtpërdrejt është mundësia e aplikimit apo shërbimit të klientit për të ndërvepruar drejtpërdrejt me ruajtësin e të dhënave, p.sh. për të përfutur pjesë nga baza e ruajtjes së të dhënave, sipas kërkesës. Kërkesa mund të bazohet në kriterin hapësinor ose kohor a në karakteristika specifike të kategorive të objekteve hapësinore, të përfaqësuara në ruajtësin e të dhënave.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Standardet e parashikuara në vendimin nr. 232, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”, do të vazhdojnë të zbatohen, për aq sa ato nuk janë në kundërshtim me standardet e parashikuara në këtë vendim.

2. Bordi Shqiptar i Gjeoinformacionit detyrohet t'i paraqesë për miratim, nëpërmjet Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshillit të Ministrave, standardet për të dhënat e përbashkëta gjeodezike dhe GIS, së bashku me strukturën, monitorimin e tyre, zbatimin dhe modifikimin.

3. Bordi Shqiptar i Gjeoinformacionit detyron autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë për zbatimin e strukturës dhe të standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS, të parashikuara në këtë vendim.

4. Agjencia e Planifikimit të Territorit detyrohet të krijojë komitete këshillimore ad-hoc, sa herë është e nevojshme, për çështje specifike me karakter teknik, për të shikuar apo për të rekomanduar rishikimin e informacioneve për standardet GIS dhe ato gjeodezike, të lidhura me planifikimin e territorit. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e komiteteve përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Punëve Publike, dhe Transportit. Këto komitete kanë të drejtë dhe detyrim t'i japin rekomandime Bordit Shqiptar të Gjeoinformacionit për rishikimin e strukturës së miratuar dhe standardeve të të dhënave gjeodezike dhe GIS.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet e tij sipas parashikimeve të shkronjës "b" të nenit 92 të ligjit nr.10119, datë 23.4 2009 "Për planifikimin e territorit".

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Metadata për shërbimet e të dhënave										
Elementi i metadatave	Përshkrimi i elementit	Shumëllojshmëri	Kusht	Nën-elementi i Metadatave	Nën-elementi i Përshkrimit	Fusha/ Lloji	Faqe e ISO 19115 / 19119 Standarte ku mund të gjendet Lista e Kodeve ose renditja	Shembull	X mënyrë	XML Emri i Elementit
Titulli i Burimit	emri nëpërmjet të cilit njihet burimi i cituar	1				Tekst i lirë		Vënia në dispozicion e hartës së Tiranës nëpërmjet internetit	identificationInfoë11/citation/*/title	titulli
Burim abstrakt	Përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së burimit	1				Tekst i lirë		Vënia në dispozicion e hartës së Bashkisë së Tiranës nëpërmjet internetit	identificationInfoë11/*/abstract	abstrakt
Lloji i Burimit	Lloji i burimit si psh. paketa e të dhënave, shërbimet etj.	1				MD_ScopeCode < <CodeList> > {paketa të dhënave, seria, shërbimi}	25/19115	shërbimi	Niveli i Hierarkisë	Niveli hierarkisë
Lloji i Shërbimit	klasifikimi për të ndihmuar në kërkimin e shërbimeve të mundshme për të dhënat hapësinore	1				{zbullo, shih, shkarko}		pamja	identificationInfoë11/*/serviceType	Lloji i Shërbimit
Lloji i lidhjes	Lloji i lidhjes midis shërbimeve dhe të dhënave të asociuara (nëse ekzistojnë)	1					4/19119 - Amendment 1/2008	përzier	identificationInfoë11/*/couplingType	Lloji i Lidhjes
Përmban Veprime	siguron informacione mbi operacionet që përfshijnë shërbimin	1...*		Emri i Operacionit	një identifikues unik për këtë ndërfaqe			Gjetja e Kapaciteteve	identificationInfoë11/*/containsOperations/*/operationName	Emri Operacionit
				DCP	platforma të shpërndara llogaritëse në të cilat është zbatuar operacioni	21/19119	Shërbimet nëpërmjet internetit	identificationInfoë11/*/containsOperations/*/DCP	DCP	
				Pika lidhëse	dorezë për të hyrë në shërbimet e ndërfaqes		http://77.242.19.116/cgi-bin/tirana_wms?service=wMS&request=GetCapabilities&version=1.1.1	identificationInfoë11/*/containsOperations/*/connectPoint	Pika lidhjes	
Identifikuesi i Burimit	informacion mbi shërbimet online nga të cilat mund të sigurohen burimet	1...*					http://77.242.19.116/cgi-bin/tirana_wms?service=wMS&request=GetCapabilities&version=1.1.1	distributionInfo/*/transferOptions/*/onLine/*/linkage	Lidhja	
Data e referencës së Burimit	Data referencës për burimet e cituara	1...*		Data	datë referencë për burimet e cituara	Data		2009-07-21	identificationInfoë11/*/citation/*/date/*/date	data
				Lloji datës	ndodhi e përdorur për datën e referencës	CI_DateTypeCode < <CodeList> >	92/19115	publikimi	identificationInfoë11/*/citation/*/date/*/dateType	Lloji Lidhjes
Fjalëkyce	fjalë të formalizuara apo frazë e përdorur për të përshkruar burimin	0...*				Tekst i lirë		Vënia në dispozicion e hartës nëpërmjet internetit	identificationInfoë11/*/descriptiveKeywords/*/keyword	Fjalëkyce
Pala përgjegjëse për burimin	identifikimin e, dhe mjetet e komunikimit me person (a) dhe organizata të lidhura me burimin	1...*		Emri i Organizatës	emri i organizatës përgjegjëse	Tekst i lirë		Departamenti i Planifikimit Urban / Bashkia e Tiranës	identificationInfoë11/*/pointOfContact/*/organisationName	Emri i organizatës
				Roli	funksion i kryer nga pala përgjegjëse	CI_RoleCode < <CodeList> >	93/19115	mbikqyrës	identificationInfoë11/*/pointOfContact/*/role	roli
				Informacioni Kontakti	si të kontaktojmë palën përgjegjëse: telefoni dhe adresa e email	CI_Contact		tel: +355-(0)4-22 12 345 email: jprec@tirana.gov.al	identificationInfoë11/*/pointOfContact/*/contactInfo/*/phone identificationInfoë11/*/pointOfContact/*/contactInfo/*/address/*/electronicMailAddress	telefoni adresa elektronike e email
				Gjatësia me kah nga Perëndimi	Kufirit të shtrirjes së burimit e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive lindore), saktësia me të paktën dy koordinata decimale	Këndi -180.0 <= Vlera e Gjatësisë me Kah nga Perëndimi <= 180.0	19.747	identificationInfoë11/*/extent/*/geographicElement/*/eastBoundLongitude	Gjatësia me kah nga Perëndimi	

Shtrirja gjeografike e burimit (nepermjet ndarjes kufizuese)	shtrirje horizontale e burimit të përfaqësuar nga një formë drejtkëndëshi ndarjes kufizuese)	0...*	e detyrueshme për shërbimet me një shtrirje të qartë gjeografike	Gjatësia me kah nga Lindja	kordinata më lindore e kufirit të shtrirjes së burimit, e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive lindore), saktësia me të paktën dy kordinata decimale	Këndi -180,0 <= Vlera e Gjatësisë me Kah nga Lindja <= 180,0	19.874	identificationInfoe11}/extent}/geographicElement}/eastBoundLongitude	Gjatësia me kah nga Lindja	
				Gjerësia me kah nga Jugu	kordinata më jugore e kufirit të shtrirjes së burimit, e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive veriore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -90,0 <= Vlera e Gjerësisë me Kah nga Jugu <= 90,0; Vlera e Gjerësisë me Kah nga Jugu <= Vlera e Gjerësisë me Kah nga Veriu	41.294	identificationInfoe11}/extent}/geographicElement}/southBoundLatitude	Gjerësia me kah nga Jugu	
				Gjerësia me kah nga Veriu	kordinata më veriore e kufirit të shtrirjes së burimit, e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive veriore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -90,0 <= Vlera e Gjerësisë me Kah nga Veriu <= 90,0; Vlera e Gjerësisë me Kah nga Veriu >= Vlera e Gjerësisë me Kah nga Jugu	41.383	identificationInfoe11}/extent}/geographicElement}/northBoundLatitude	Gjerësia me kah nga Veriu	
Poligoni kufizues I burimit	Kufiri i mbyllur i burimit shprehur në kordinata x y	0...*		Poligon	poligon kufizues i përfaqësuar nga kordinata çift	gml:polygon	sipas përkaftimit të gml:poligon në ISO 19136	identificationInfoe11}/extent}/geographicElement}/polygon	poligon	
Kushtet për akses dhe përdorim	përcakton kushtet për akses dhe përdorim e paketës së të dhënave hapësinore, dhe ku është e mundur, tarifat korresponduese	1...*				Tekst i lirë	nuk ka kushte	identificationInfoe11}/resourceConstraints}/useLimitation	Kufizim përdorimi	
Kufizimet për aksesin e publikut	nëse mundet, të dhënat për kufizimet e aksesit publik dhe arsytet për to	1...*				Tekst i lirë	nuk ka kufizime	identificationInfoe11}/resourceConstraints}/accessConstraints	Kufizim aksesit	
Identifikuesi i skedarit të metadatave	identifikues unik për këtë skedar të metadatave	1				Tekst i lirë	b45aa5df-d9bf-4a66-916c-36f1d96e43	Identifikuesi i dosjes	Identifikuesi i skedarit	
Emri standard i metadatave	Emri standardit i metadatave i përdorur	1				Tekst i lirë	ISO 19115 / 19119	Emri standard I metadatave	Emri standard i metadatave	
Gjuha e metadatave	gjuha e përdorur për dokumentimin e metadatave	1				ISO 639-2	Anglisht	Gjuha	Gjuha	
Set i karaktereve të metadatave	emri i plotë i karakterit që kodon standartet e përdorura për paketën e metadatave	1				MD_CharacterSetCode <<CodeList>>	95/19115	utf8	Paketa e Karaktereve	Paketa e karaktereve
Pika e kontaktit të metadatave	pala përgjegjëse për informacionin e metadatave	1...*		Emri i Organizatës	emri i organizatës përfaqësuese	Tekst i lirë		Departamenti i Planifikimit Urban / Bashkia e Tiranës	contact}/organisationName	Emri i organizatës
				Roli	funkcion i kryer nga pala përgjegjëse	CI_RoleCode <<CodeList>>	93/19115	mbikqyrës	contact}/role	roli
				Informacioni Kontakti	si të kontaktojmë palën përgjegjëse: telefon dhe adresë email	CI_Contact		Tel: +355-(0)4-22 12 345 email: jpreci@tirana.gov.al	contact}/contactInfo}/phone contact}/contactInfo}/address}/electronicMailAddress	telefon postë elektronike adresë
Vula e datave të metadatës	data në të cilën ishte krijuar metadata	1				Data	2009-10-22	Vula e datës	Vula e datës	

Metadata për paketat e të dhënave hapësinore dhe serive të paketave të të dhënave										
Elementi i Metadatave	Elementi i Përshkrimit	Shumëllojshmëria	Kushti	Nënelement i metadatave	Përshkrimi i nënelementit	Domeini / Tipi	Faqja e ISO 19115 Standarti ku mund të gjendet lista e kodit apo emërimit	Shembull	X Mënyrë	Emri i elementit XML
Titulli i burimit	Emri me të cilin njihet burimi i caktuar	1				Tekst I lirë		ndërtesa	Informacion identifikimi1c/*/citimi/*/titulli	titulli
Burim abstrakt	Përmbledhje e shkurtër narrative e përmbajtjes së burimit	1				Free text		Ndërtesa brenda kufijve administrativë të Bashkisë së Tiranës	Informacion identifikimi1c/*/abstrakt	abstrakt
Lloji i burimit	Lloji i burimit si për shembull paketa e të dhënave, shërbimi etj.	1				MD_Kodi I Fushës << Lista e Kodit >> {seti I të dhënave, seritë, shërbimi}	25	Seti I të dhënave	Niveli I hierarkisë	Niveli hierarkisë
Identifikuesi i Burimit	Informacion për burimet online nga të cilat mund të sigurohet burimi	0...*		I detyrueshëm në rast se ekziston një URL për të siguruar informacion të mëtejshëm për burimin		URL		http://www.tirana.gov.al/spatialdata/buildings.zip	Informacion I shpërndarë/*Opsione transferimi/*/lidhje onLine	Lidhjet
Gjuha e burimit	Gjuha e përdorur brenda burimit	1...*				ISO 639-2		sqi, eng	Informacion identifikimi1c/*/gjuha	Gjuha
Seti i karaktereve të burimit	Emri I plotë I karakterit që kodon standartet që përdoren për burimin	1...*				MD_Karakterit I Kodit të Fushës << Lista e Kodit >>	95	utf8	Informacion identifikimi1c/*/Seti I karaktereve	Seti I karaktereve
Data e referencës së burimit	Data e referencës për burimin e caktuar	1...*		Data	Data e referencës për burimin e caktuar	Data		2005-08-25	Informacion identifikimi1c/*/citimi/*/data/*/data	data
			Lloji I datës	Eventi I përdorur për datën e referencës	CI_Data e Kodit Tip << Lista e Kodit >>	92	Publikimi	Informacion identifikimi1c/*/citimi/*/data/*/Lloji I datës	Lloji I datës	
Kategoria e temës	Tema (t) kryesore të paketave të të dhënave apo serive të paketave të të dhënave	1...*				MD_Kodi I Kategorisë së Temës << Numërimi >>	102	Struktura, planifikimi Kadastra	Informacion identifikimi1c/*/Kategoria e temës	Kategoria e temës
Fjalëkyçe	Fjalë që përdoret shpesh, fjalë e formalizuar apo frazë që përdoret për të përshkruar burimin	0...*				Tekst I lirë		Ndërtesë, Ndërtim	Informacion identifikimi1c/*/Fjalëkyçe përshkruese/*/fjalëkyç	Fjalëkyçe
Pala përgjegjëse për burimin	identifikimi dhe mjetet e komunikimit me personin (at) dhe organizatat që lidhen me burimin	1...*		Emri I organizatës	Emri I organizatës përgjegjëse	Tekst I lirë		Drejtoria e Planifikimit Urban / Bashkia e Tiranës	Informacion identifikimi1c/*/Pika e kontaktit/*/organizata Emri	Emri I organizatës
				Roli	funkcioni I kryer nga pala përgjegjëse	CI_Kodi I Rolit << Lista e Kodit >>	93	Mbikqyrësi	Informacion identifikimi1c/*/Pika e kontaktit/*/rol	rol
				Informacioni I kontaktit	Si të kontaktojmë palën përgjegjëse: numri I telefonit dhe adresa e postës elektronike	CI_Kontakti		telefon: +355-(0)4-22 12 345 email: jpreci@tirana.gov.al	Informacion identifikimi1c/*/Pika e kontaktit/*/informacion kontakti/*/telefon Informacion identifikimi1c/*/Pika e kontaktit/*/informacion kontakti/*/adresa/*/adresa e postës elektronike	Telefon postë elektronike IAdresë
Shtrirja gjeografike e burimit (nëpërmjet ndarjes kufizuese)	Shtrirja horizontale e burimit e përfaqësuar nga një formë katërkëndëshe	1...*		Gjatësia me kahje nga perëndimi	Koordinata më perëndimore e kufirit të shtrirjes së burimit e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive lindore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -180,0 <= Vlera e Gjatësisë me Kahje nga Perëndimi <= 180,0		19.747	Informacion identifikimi1c/*/shtrirja/*/Elementi gjeografik/*/Gjatësia me kahje nga perëndimi	Gjatësia me kahje nga perëndimi
				Gjatësia me kahje nga lindja	Koordinata më lindore e kufirit të shtrirjes së burimit e shprehur në gjatësi në shkallë decimale (pozitive lindore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -180,0 <= Vlera e Gjatësisë me Kahje nga Lindja <= 180,0		19.874	Informacion identifikimi1c/*/shtrirja/*/Element gjeografik/*/Gjatësia me kahje nga lindja	Gjatësia me kahje nga lindja

				Gjerësia me kahje nga jugu	Koordinata më jugore e kufirit të shtrirjes së burimit e shprehur në gjerësi në shkallë decimale (pozitive veriore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -90.0 <= Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Jugu <= 90.0; Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Jugu <= Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Veriu		41.294	Informacion identifikimi1c/*/shtrirja/*Element gjeografik/*Gjerësia me kahje nga jugu	Gjerësia me kahje nga jugu
				Gjerësia me kahje nga veriu	Koordinata më veriore e kufirit të shtrirjes së burimit e shprehur në gjerësi në shkallë decimale (pozitive veriore), saktësia me të paktën dy decimale	Këndi -90.0 <= Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Veriu <= 90.0; Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Veriu >= Vlera e Gjerësisë me Kahje nga Jugu		41.383	Informacion identifikimi1c/*/shtrirja/*Element gjeografik/*Gjerësia me kahje nga veriu	Gjerësia me kahje nga veriu
Poligoni kufizues i burimit	Kufi i mbyllur i burimit i shprehur në koordinat x-y	0...*		Poligoni	Poligon kufizues i përfaqësues nga çifte koordinatash	gml:poligoni		Sipas përcaktimit të gml-së:poligoni në ISO 19136	Informacion identifikimi1c/*/shtrirja/*Element gjeografik/*poligoni	poligoni
Rezolucioni hapësinor i setit të të dhënave	Niveli i detajit të shprehur si faktor shkalle apo distancë nga toka	0...*		Shkalla ekuivalente	Niveli i detajeve të shprehura si shkallë e një hartë printuar të krahasuar apo një diagrami	Numër i plotë > 0 (Fraksioni përfaqësues)		2500	Informacion identifikimi1c/*/Rezolucioni hapësinor/*Shkalla ekuivalente/*Emëruesi	Emëruesi
				Distanca	Shembull i distancës nga toka	Distanca > 0		25 cm	Informacion identifikimi1c/*/Rezolucioni hapësinor/*Shkalla ekuivalente/*distanca	distanca
Mirëmbajtja e burimit	informacion për shpeshësinë e rifreskimit	0...1		Mirëmbajtja dhe rifreskimi i shpeshmërisë	Shpeshmëria me të cilën bëhen ndryshime dhe shtesa në burim pasi të jetë plotësuar burimi fillestar	MD_Kodi i Mirëmbajtjes së Shpeshmërisë < < Lista e Kodit >	25	Një herë në dy vjet	Informacion identifikimi1c/*/Mirëmbajtja e burimit/*Mirëmbajtja dhe Shpeshmëria e Rifreskimit	Mirëmbajtja dhe Shpeshësia e Rifreskimit
				Data e rifreskimit të ardhshëm	Planifikimi i të dhënave të rishikuara për burimin	Data		2009-03-25	Informacion identifikimi1c/*/Mirëmbajtja e burimit/*data e rifreskimit të ardhshëm	Data e rifreskimit të ardhshëm
Formati i shpërndarjes	Siguron një përshkrim të formatit të të dhënave që do të shpërndahen	0...*		Emri	Emri i formateve të transferimit të të dhënave	Tekst i lirë		ESRI Shapefile	Informacion shpërndarje/*Formati i shpërndarjes/*emri	emri
				Versioni	Versioni i formatit (numri i datës, etj.)	Tekst i lirë		ArcView 9.3.1	Informacion shpërndarje/*Formati i shpërndarjes/*versioni	versioni
Tipi i përfaqësimit hapësinor	metodë e përdorur për përfaqësimin hapësinor të informacionit gjeografik	0...*				MD_Lloji i Kodit për Përfaqësimin Hapësinor < < Lista e Kodit >	102	vektor	Informacion identifikimi1c/*/Lloji i Përfaqësimit Hapësinor	Lloji i përfaqësimit hapësinor
Sistemi i referencës hapësinore	Përshkrimi sistemeve të referencës hapësinore i përdorur në burim	1...*	Identifikimi i preferuar i sistemit të referencës së koordinatave është kodi/identifikuesi EPSG. Në rast se kodi EPSG nuk është siguruar, atëherë projekcioni, elipsoidi dhe pika e referimit janë të detyrueshme.	Identifikuesi i sistemit të referencës	name / identifier of reference system	RS Identifikues		Kodi: 32634 Hapësira e Kodit: EPSG	Informacion i sistemit të referencës/*Identifikuesi i sistemit të referencës/*kodi Informacion i sistemit të referencës/*Identifikuesi i sistemit të referencës/*Hapësira e kodit	Kodi Hapësira e kodit
Prejardhja	Shpjegim i përgjithshëm i njohurive që zotëron krijuesi i të dhënave për prejardhjen e burimit	0...1				Tekst i lirë		Ndërtesat u hodhën në format dixhital nga ortofotot e marra në mars 2005. Informacioni përshkruet si funksioni i ndërtesës, lartësia dhe gjendja u siguroa nga studimet në terren.	Informacioni i cilësisë së të dhënave/*{Prejardhja	Prejardhja
Përshkrimi i katalogut të veçorive	informacion që identifikon katalogun e veçorive	0...1		Gjuha	Gjuha e përdorur brenda katalogut	ISO 639-2		sqi	Informacion i përmbajtjes/*gjuha	Gjuha
				E përfshirë me setin e të dhënave	Treguesi nëse katalogu i veçorive është përfshirë apo jo me paketën e të dhënave	Boolean		0 (no)	Informacion i përmbajtjes/*I përfshirë me setin e të dhënave	I përfshirë me paketën e të dhënave

				Citimi i katalogut	Referencë e përfunduar bibliografike e katalogut të veçrive të jashtme	CI_Citimi		titulli: ndërtesa data: 2008-06-05 Lloji i datës: publikim Pala përgjegjëse: Drejtoria e Planifikimit Urban /Bashkia e Tiranës Burimi-online: http://www.tirana.gov.al/feature_catalogues/buildings_c at.xls	Informacion i përbajtjes/*Citimi i Katalogut të Veçorisë/*titulli Informacion i përbajtjes/*Citimi i Katalogut të Veçoris/*data/*data Informacion i përbajtjes/*Citimi i Katalogut të Veçoris/*data/*Lloji i datës Informacion i përbajtjes/*Citimi i Katalogut të Veçoris/*Pala Përgjegjëse e cituar/*Emri i organizatës Informacion i përbajtjes/*Citimi i Katalogut të Veçoris/*Pala Përgjegjëse e cituar/*Informacion kontakti/*Burim online/*Lidhje	titulli data Lloji i datës Emri i organizatës Lidhjet
				Kodi i Përputhshmërisë	Treguesi i përputhshmërisë së katalogut të veçrive të jashtme me ISO 19110	Boolean		1 (po)	Informacion kontakti/*Kodi I përputhshmërisë	Kodi I Përputhshmërisë
Kushtet për akses dhe përdorim	Përcakton kushtet për akses dhe përdorimin e seteve të të dhënave hapësinore dhe kur është e mundur, tarifat përkatëse	1...*				Tekst i lirë		Nuk aplikohen kushtet	Informacion identifikimi1ç/*Kufizime të burimit/*Kufizim përdorimi	Kufizim përdorimi
Kufizimet ndaj aksesit publik	Nëse është e aplikueshme, informacion për kufizimet ndaj aksesit publik dhe arsyet për këto kufizime	1...*				Tekst i lirë		Nuk ka kufizime	Informacion identifikimi (1ç/*Kufizime të burimit/*Kufizime të aksesit	Kufizim aksesit
Identifikuesi I dosjes së metadatave	identifikuesi unik për këtë dosje metadash	1				Tekst i lirë		b45aa5df-d9bf-4a66-916c-36ff1d96e43	Identifikuesi I dosjes	Identifikuesi I dosjes
Emri standart I metadatave	Emri I standartit të përdorur për metadatat	1				Tekst i lirë		ISO 19115	Emri standard I metadatave	Emri standard I metadatave
Gjuha e metadatave	Gjuha e përdorur për dokumentimin e metadatave	1				ISO 639-2		eng	Gjuha	gjuha
Seti I karaktereve të metadatave	Emri I plotë i karakterit që kodon standartin që përdoret për setin e metadatave	1				MD Kodi i Paketës së Karaktereve <Lista e Kodit >	95	utf8	Seti I karaktereve	Paketa e karaktereve
Pika e kontaktit e metadatave	Pala përgjegjëse për informacionin e metadatave	1...*		Emri I organizatës	Emri I organizatës përgjegjëse	Tekst i lirë		Drejtoria e Planifikimit Urban/Bashkia e Tiranës	Kontakti/*Emri I organizatës	Emri I organizatës
				Roli	Funksioni I kryer nga pala përgjegjëse	CI_Kodi i Rolit < <Lista e Kodit >	93	Mbikqyrësi	Kontakti/*roli	roli
				Informacioni I kontaktit	Si të kontaktojmë palën përgjegjëse: numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike	CI_Kontakti		Telefon: +355-(0)4-22 12 345 email: jpreci@tirana.gov.al	Kontakti/*Informacion kontakti/*Telefon Kontakti/*Informacion kontakti/*Adresa/*Adresa e postës elektronike	telefon postë elektronike adresë
Vula e datës së metadatave	Data kur janë krijuar metadatat	1			Data		2008-10-22	Vula e datës	Vula e datës	

VENDIM
Nr.460, datë 16.6.2010

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

1. Regjistri i Planifikimit të Territorit është një inventar elektronik dhe shkresor publik për informacionin lidhur me planifikimin e territorit, që krijohet, ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur nga autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike. Regjistri përmban:

- a) informacion për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit;
- b) projektakte dhe akte të planifikimit të territorit, të përdorimit e të pronësisë së tokës;
- c) kërkesat për zhvillimin e tokës dhe lejet e zhvillimit, së bashku me të drejtat ose kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre.

Informacionet e mësipërme duhet të regjistrohen në portalin web të regjistrit, i cili është një rrjet i integruar dhe shumëfunksional për shkëmbimin elektronik të informacionit.

2. Informacioni në Regjistrin e Planifikimit të Territorit mirëmbahet dhe përditësohet nga autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit, institucionet e tjera publike, që krijojnë një bazë të dhënash të pavarur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në përputhje me nenin 51 të ligjit nr.10 119, datë 29.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Personat juridikë mund të kontribuojnë me informacion për planifikimin e territorit në portalin web të regjistrit.

3. Informacioni elektronik në portalin web të regjistrit administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet në një rrjet të integruar e shumëqëllimësh bazash të dhënash, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Aksesit në Regjistrin e Planifikimit të Territorit sigurohet përmes portalit të rrjetit, që përfaqëson pikën qendrore për përfitim të shërbimeve që ofrohen nga ky Regjistrë.

4. Të dhënat hapësinore dhe informacionet për planifikimin e territorit në format elektronik regjistrohen në portalin web të regjistrit nga autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, sipas strukturës dhe standardeve të parashikuara në vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe të udhëzimeve të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, në lidhje me strukturën, përmbajtjen dhe formatin e të dhënave të kërkuara.

5. Informacioni elektronik në Regjistrin e Planifikimit të Territorit krijohet, ruhet, administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet në mënyrë të decentralizuar nga autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë që kontribuojnë proporcionalisht në ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e këtij regjistri. Këto autoritete kanë të drejtë të ndryshojnë dhe të përditësojnë informacionin që disponojnë ose t’ua delegojnë këtë kompetencë personave juridikë që mund të caktohen prej tyre.

6. Autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, që regjistrojnë informacion në portalin web të regjistrit, garantojnë që ndërveprimi i komunikimeve elektronike ndërmjet bazave të të dhënave të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale. Mbrojtja e këtyre të dhënave ka për qëllim moslejimin e përfimit të informacionit në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe me aktet e nxjerra nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, që regjistrojnë informacion në portalin web të regjistrit, garantojnë që ndërveprimi i komunikimeve elektronike ndërmjet bazave të të dhënave të sigurojë mbrojtjen e informacionit për sigurinë kombëtare, sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””. Mbrojtja e informacionit për sigurinë kombëtare ka për qëllim moslejimin e përfuturit të informacionit në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

8. Arkitektura e rrjetit të portalit web të regjistrit lejon ndërveprimin e informacionit të regjistruar, ndërmjet vetë bazave të pavarura të të dhënave, si dhe ofrimin e shërbimeve për publikun, nëpërmjet aksesit në një portal qendror. Arkitektura e këtij rrjeti lejon që informacioni i regjistruar në portalin web të regjistrit të administrohet, të ruhet, të mirëmbahet dhe të përditësohet nga çdo krijues i tij.

9. Portali web i regjistrit përbën një rrjet ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave, që i ofrojnë publikut shërbimin e zbulimit, të shikimit dhe të shkarkimit elektronik të informacionit të regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit. Portali qendror lejon ofrimin e këtyre shërbimeve për përdoruesit e rrjetit nga çdo bazë të dhënash, që është pjesë e këtij regjistri. Ky portal lejon shpërndarjen dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet bazave të pavarura të të dhënave.

10. Shërbimi i zbulimit në portalin web të regjistrit i krijon mundësinë përdoruesit të kërkojë dhe të gjejë informacionin elektronik, të ruajtur në regjistër, nëpërmjet përdorimit të një grupi kriteresh kërkimi.

11. Shërbimi i shikimit të portalit web të regjistrit i krijon mundësinë çdo përdoruesi për të shikuar çdo informacion elektronik, që ofrohet nga regjistri.

12. Shërbimi i shkarkimit të portalit web të regjistrit i krijon mundësinë përdoruesit për të përfutur në mënyrë elektronike të dhëna ose pjesë të tyre të paracaktuara, si dhe për të pasur akses të drejtpërdrejtë në shërbimet e rrjetit për të përfutur informacion nga regjistri.

13. Ngritjen dhe funksionimin e qendrave të asistencës së regjistrit të Planifikimit të Territorit në 12 qarqe të territorit të Republikës së Shqipërisë. Qendrat e asistencës sigurojnë asistencë teknike për autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, sipas nevojës, nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për regjistrimin, ruajtjen, administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

14. Qendrat e asistencës, gjithashtu, duhet të garantojnë akses të informacionit elektronik, që përfshihet në regjistër, nëpërmjet portalit web, duke mundësuar zbulimin, shikimin dhe shkarkimin e informacionit të kërkuar nga publiku. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit boton rregulla për mënyrën e aksesimit nga publiku të këtyre shërbimeve në qendrat e asistencës.

15. Qendrat e asistencës asistojnë autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, me qëllim që regjistrimi i të dhënave në portalin web të Regjistrit të kryhet në përputhje me parashikimet e vendimit nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe me udhëzimet e ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit për strukturën, përmbytjen dhe formatin e të dhënave.

II. INFORMACIONI QË REGJISTROHET DHE PUBLIKOHET NË REGJISTËR

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, për realizimin dhe monitorimin e detyrave në fushën e planifikimit të territorit, duhet që, brenda një afati kohor të përcaktuar, të ndërtojnë, të menaxhojnë dhe të mirëmbajnë informacionin për planifikimin e territorit, të cilin janë të detyruar ta dërgojnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

2. Sistemi i informacionit të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, sipas nenit 55 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, ndërtohet në dy faza:

- a) Regjistrimi dhe publikimi i të dhënave të krijuara gjatë zbatimit të ligjit;
- b) Regjistrimi dhe publikimi i të dhënave të krijuara gjatë zbatimit të ligjit sipas legjislacionit sektorial në fuqi.

3. Duke përmbledhur të dyja fazat në një të vetme, regjistri do të përmbajë të dhënat e mëposhtme, që i përkasin planifikimit të territorit, për:

a) gjendjen aktuale të territorit, bazuar në regjistrin e pronave të paluajtshme;
b) rrjetet e infrastrukturës publike, për ndërtesat dhe për territoret e tyre;
c) statusin ligjor të territorit, bazuar në dokumentet e planifikimit të territorit e të përdorimit të tokës;

ç) zona të veçanta, me regjim ligjor të veçantë, të përcaktuar në bazë të legjislacionit apo të rregulloreve sektoriale, si zona të mbrojtura, me rrezikshmëri etj.

d) trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen natyrore, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në rregulloret për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e ruajtjen e natyrës;

dh) hartimin, miratimin dhe monitorimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit.

Struktura, përmbajtja dhe formati për këto të dhëna do të përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

4. Në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të dhënat për statusin aktual të territorit, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të këtij kreu, janë të detyrueshme për hartimin e planeve territoriale nga ana e autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit.

5. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit të territorit janë të detyruara me ligj që të publikojnë informacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, secila sipas fushës së veprimit dhe kompetencës, për shikim, zbulim dhe shkarkim prej publikut.

III. RREGULLAT PËR SIGURINË DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike shpërndajnë e shkëmbejnë të dhënat nëpërmjet përdorimit të sistemeve të komunikimeve elektronike. Ato i depozitojnë dhe i transferojnë këto të dhëna, me qëllim mbrojtjen, garantimin e sigurisë dhe paprekshmërinë e tyre.

Këto sisteme sigurojnë:

- a) rikuperimin e të dhënave në çdo kohë;
- b) sigurimin dhe mbrojtjen e të dhënave ndaj aksesit të paautorizuar;
- c) paprekshmërinë e të dhënave gjatë shkëmbimit të ndërsjellë të tyre.

2. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike e depozitojnë të gjithë informacionin për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit në një server të bazës së të dhënave, të mirëmbajtur prej tyre.

3. Çdo person juridik, që mirëmban serverin ku regjistrohet informacioni i Regjistrimit të Planifikimit të Territorit, kryen dublikimin elektronik (back-up) për të gjitha të dhënat e serverit me qëllim rikuperimin e tyre në çdo kohë. Për informacionin e regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, autoritetet e planifikimit detyrohen të mbajnë një kopje të njëjtë me informacionin e regjistruar në këtë regjistër brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre.

4. Çdo person, që mirëmban serverin ku ndodhet informacioni i regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, zbaton masat e sigurisë për parandalimin e aksesit të padëshiruar që mund të sjellë dëmtime të këtyre të dhënave në server nëpërmjet transmetimit të viruseve.

5. Çdo person, që mirëmban serverin ku ndodhet informacioni i regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, zbaton standardet e sigurisë për sigurimin dhe mbrojtjen e paprekshmërisë të së dhënave, nëpërmjet përdorimit të protokolleve të përshtatshme për shkëmbimin e informacionit.

6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit harton rregullat për garantimin e sigurisë dhe paprekshmërinë e të dhënave në bazën e të dhënave të Regjistrimit të Planifikimit të Territorit, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

IV. RREGULLAT PËR STANDARDET E PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE

1. Programet kompjuterike, që do të përdorin autoritetet e planifikimit për sistemet apo mjetet e komunikimeve elektronike në bazat e të dhënave, duhet të jenë sipas standardeve të hapura

(open standards). Këto programe duhet të sigurojnë ndërveprimin ndërmjet bazave të të dhënave të autoriteteve të planifikimit me bazat e tjera të të dhënave, që nuk janë pjesë përbërëse e Regjistrit të Planifikimit të Territorit.

2. Për arsye të ndërveprimit ndërmjet vetë bazave të të dhënave, programet kompjuterike, që do të përdoren nga autoritetet e planifikimit dhe institucionet publike, duhet të garantojnë regjistrimin e të dhënave dhe të metadatave, në përputhje me vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, të cilat duhet të jenë të shkëmbyeshme nëpërmjet bazave të të dhënave.

3. Programet kompjuterike garantojnë kodimin e të dhënave personale, që parashikohen si të tilla në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të informacionit për sigurinë kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

V. FINANCIMI PËR KRIJIMIN DHE PËR VËNIEN NË FUNKSIONIM TË REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

1. Shpenzimet e nevojshme për krijimin dhe për mirëmbajtjen e të dhënave të planifikimit të territorit, përfshirë dhe Regjistrin e Planifikimit të Territorit, për shkëmbimin e vazhdueshëm elektronik të informacionit nëpërmjet portalit web qendror, që përfshin baza të pavarura të dhënash, rrjete sistemesh, pajisje, si dhe për ngritjen e mirëmbajtjen e portalit web me aplikacione software të planifikimit të territorit, përballohen nga buxhetet e autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit, si dhe nga buxhetet e institucioneve të tjera publike.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të nevojshme kompjuterike hardware dhe software për funksionimin e portalit qendror të Regjistrit të Planifikimit të Territorit dhe të aplikacioneve software për autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit të territorit, nëpërmjet portalit qendror. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit krijon sportele në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, të pajisura me pajisje hardware dhe software. Këto sportele kanë mundësinë për t'u lidhur, nëpërmjet internetit, me portalin web të Regjistrit. Shpenzimet për kryerjen e funksioneve do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit duhet të parashikojnë shpenzimet e nevojshme për krijimin dhe vënien në funksionim të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, parashikime të cilat ua paraqesin organeve të ngarkuara me ligj, për përfshirjen e tyre në projektbuxhetet e çdo viti buxhetor.

4. Shpenzimet korrente të kërkuara nga autoritetet planifikuese për administrimin e bazës së pavarur të të dhënave, që ato mirëmbajnë si pjesë e Regjistrit të Planifikimit të Territorit, përfshirë punonjësit shtesë, si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike hardware dhe software në nivel lokal, do të financohen nëpërmjet fondeve të pakushtëzuara, të miratuara në ligjin vjetor për njësitë e qeverisjes vendore. Shuma e fondeve të parashikuara për autoritetet vendore, në lidhje me Regjistrin e Planifikimit të Territorit, i shtohet totalit të transfertës së pakushtëzuar.

5. Shpenzimet kapitale të autoriteteve planifikuese për ngritjen e informacionit që ato kërkojnë të përfshijnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit për zhvillimin e masterplaneve, konvertimin e informacionit në formate dixhitale, përfshirë edhe formatin GIS, si dhe për blerjen e pajisjeve kompjuterike hardware dhe software nga autoritetet e planifikimit vendor do të përballohen nga:

a) transfertat, nga fondet për zhvillimin e rajoneve nga Buxheti i Shtetit, autoriteteve të planifikimit vendor, në përputhje me një formulë korresponduese, sipas së cilës 80% e shpenzimeve kapitale të planifikuara do të përballohen nga fondet për zhvillimin e rajoneve dhe 20% nga kontributi i vetë autoriteteve vendore;

b) financime të huaja nga projekte dhe programe;

c) burime të tjera të lira të ardhurash të pushtetit vendor.

VI. BOTIMI NË REGJISTRIN E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike detyrohen të botojnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit të gjitha projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

2. Projektaktet ose aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu, *inter alia*, përfshijnë:

- a) projektakte të rëndësisë kombëtare;
- b) projekte dhe projekte përfundimtare të instrumenteve të planifikimit;
- c) propozime dhe/ose kundërshtime për projektin e instrumenteve të planifikimit;
- ç) vendime miratimi të planifikimit të instrumenteve, që përfshijnë politika, strategji, rregulla të planifikimit ose pjesë përbërëse të tyre, si dhe materiale plotësuese;
- d) vendime për miratimin e instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit të territorit;
- dh) vendime për pezullim zhvillimi;
- e) vendime të rëndësisë kombëtare;
- ë) studime dhe planveprime të projekteve të instrumenteve të planifikimit të territorit;
- f) kërkesa për zhvillim së bashku me dokumentet e kërkuara për paraqitjen e këtyre kërkesave;
- g) raporte që përmbajnë propozimet për miratime të kërkesave për zhvillim;
- gj) vendime për miratimin ose refuzimin e kërkesave për zhvillim;
- h) njoftimet për zhvillim që planifikohen nga zhvilluesi;
- i) njoftime për dhënie lejeje zhvillimi-ndërtimi-infrastruktura ose përdorimi;
- j) raportin vjetor të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si dhe raporte të çdo autoriteti tjetër përgjegjës të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit;
- k) projektakte ose akte që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

Struktura, përmbajtja dhe formati i të dhënave përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë mund të botojnë në portalin web të regjistrin dokumente të tjera që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

Projektaktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij kreu, botohen menjëherë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

4. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit, që miratojnë projektakte dhe akte në zbatim të neneve 65, 66, 67, 68 e 69 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, janë të detyruara që, përveç botimit të tyre në portalin web të regjistrin, të njoftojnë zyrën përgjegjëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5. Projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit dhe që klasifikohen “sekret shtetëror” në kuptim të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, nuk duhet të zbulohen, të shikohen ose të shkarkohen për përdorim nga publiku. Shikimi, zbulimi dhe shkarkimi i tyre nga publiku trajtohen sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

6. Botimi në bazën e të dhënave dhe në letër i projektakteve ose i akteve në portalin web të regjistrin sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij kreu, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore, nëse botimi i tyre realizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Regjistri i Planifikimit të Territorit krijohet më qëllim organizimin dhe vënien në funksionim të tij, në dy faza:

- a) Regjistrimi dhe botimi i të dhënave në zbatim të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”;
- b) Regjistrimi dhe botimi i të dhënave të krijuara në zbatim të legjislacionit sektorial.

Nëse gjatë procesit të regjistrimit dhe të botimit të të dhënave lind nevoja për ndryshime ligjore, këto ndryshime duhet të jenë të harmonizuara me dispozitat ligjore që i takojnë Regjistrin të Planifikimit të Territorit.

2. Faza e parë përfshin regjistrimin elektronik dhe botimin e informacionit për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit nga autoritetet e planifikimit. Regjistrimi dhe botimi i këtij informacioni kryhen sipas standardeve të parashikuara në vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Faza e dytë përfshin regjistrimin dhe botimin në bazat e të dhënave të informacionit të institucioneve shtetërore që nuk është objekt i ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, por që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me qendrat e asistencës në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, si dhe autoritetet e planifikimit, marrin masa për krijimin e portalit qendror të Regjistrimit të Planifikimit të Territorit.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, marrin masa për krijimin e strukturave përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave të tyre, si dhe për shkëmbimin e informacionit për planifikimin e territorit nëpërmjet portalit web të regjistrimit.

6. Nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit krijohen komitetet ad-hoc, përbërja e të cilave përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, sipas propozimit të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

7. Komitetet ad-hoc, të krijuara sipas pikës 6 të këtij kreu, ushtrojnë funksione këshillimore për Bordin e Gjeoinformacionit. Këto komitete kanë të drejtë t’i paraqesin rekomandime, me shkrim, Bordit të Gjeoinformacionit, në lidhje me:

a) monitorimin e zbatimit të standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS sipas përcaktimeve të vendimit nr.459, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”;

b) ndryshimin e strukturës të së dhënave dhe të *metadatave*;

c) paraqitjen e propozimeve Bordit të Gjeoinformacionit për pranimin e standardeve të reja gjeodezike dhe GIS, si dhe për përditësimin e tyre.

8. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit bashkërendon veprimtarinë e saj me institucionet shtetërore, përgjegjëse për regjistrimin e informacionit, lidhur me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, të krijuar sipas legjislacionit sektorial në fuqi, si dhe përgatit, në bashkëpunim me to, planin e veprimit për fazën e dytë.

9. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit miraton manuale dhe rregullore për autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, për regjistrimin e informacionit në portalin web të regjistrimit.

10. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është organi mbikëqyrës që kontrollon mënyrën e regjistrimit dhe të botimit të informacionit në portalin web të regjistrimit nga autoritetet qendrore dhe vendore të planifikimit të territorit, si dhe i udhëzon këto autoritete të regjistrojnë të dhënat e tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

11. Deri në datën e fillimit të efekteve të plota të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me qendrat e asistencës në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, të marrë masa për trajnimin e personelit administrativ, të ngarkuar me regjistrimin, ruajtjen, administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit në portalin web të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet e tij sipas parashikimeve të shkronjës “b” të nenit 92 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.5, datë 30.6.2010

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 13.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E RENDITJES SË PUNËVE NË SHËRBIMIN CIVIL,
METODOLOGJINË PËRKATËSE DHE PËRSHKRIMIN PËRGJITHËSUES TË ROLIT TË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KËTË SHËRBIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Në fund të aneksit nr.2 të udhëzimit nr.1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit civilë të cilët kanë një Diplomë të Nivelit të Parë (DNP) në degët Inxhinieri Elektronike ose Informatikë, të emëruar deri në datën 1 prill 2010, sipas procedurave të legjisllacionit të shërbimit civil, në pozicione që lidhen me informatizimin e administratës publike e që u përkasën shkallëve 12,13,14,16 dhe 18, dhe që aktualisht vazhdojnë programet e studimeve të ciklit “Master i Nivelit të Parë” ose programet e studimeve të ciklit të dytë, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë emëruar, me kushtin që, deri jo më shumë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të pajisen me një diplomë Master i Nivelit të Parë (MNP), ose Diplomë e Nivelit të Dytë (DND).”.

2. Ngarkohen ministratë e linjës dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.4489, datë 6.5.2010

**PËR FURNIZIMIN NGA RAFINERITË DHE SHOQËRITË E TREGTIMIT ME SHUMICË
TË LËNDËS DJEGËSE QË NUK PËRDORËT PËR AUTOMJETE RRUGORE DHE
GJENERATORË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 12,14,23 dhe 24 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.170, datë 29.3.2006 “Për ngjyrosjen e lëndës djegëse për automjetet me motor diezel, si dhe të lëndës djegëse, që importohet për qëllime industriale e publike”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, të kreut V të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pjesës XIII të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1.Subjektet e pajisura me lejet/licencat përkatëse sipas legjisllacionit në fuqi, të cilat prodhojnë dhe/ose importojnë lëndë djegëse, për qëllime industriale dhe publike, që në

nomenklaturën e mallrave nuk përfshihen në lëndë djegëse për automjetet rrugore dhe gjeneratorë (me kod 27101941, me cilësi sipas standardit S.Sh.EN 590, dhe me përmbajtje squfuri deri në 350 mg/kg deri me 31.12.2010, si dhe lëndë djegëse me cilësi sipas standardit S.Sh.EN 228) do të prodhojnë brenda vendit, importojnë dhe tregtojnë këto produkte të cilat të kenë destinacion përdorimi të ndryshëm nga tregtimi për automjete rrugore dhe gjeneratorë, vetëm pasi të jenë denaturuar duke u ngjyrosur me bojë sipas përcaktimit në pikën 2.

2.E gjithë sasia e prodhuar në vend dhe/ose importuar, denaturohet duke u ngjyrosur me bojë të kuqe sipas standardit të BE-së. Niveli i ngjyritimit duhet të jetë jo më ak se 9 mg/l lëndë djegëse. Ngjyrosja është detyrim i subjektet prodhues dhe/ose importues dhe kryhet:

-Për prodhuesin, në depon e nënprodukteve të naftës, të miratuar si magazina tatimore nga organi tatimor, sipas kërkesës së personit të autorizuar si tatimpagues akcize.

-Për importuesin në magazinën doganore përpara se malli të hidhet në qarkullim të lirë.

Ngjyrosja do të kryhet në prezencën e inspektorit/eve të IQT-së dhe autoritetit doganor/tatimor, nën juridiksionin e të cilëve është subjekti. IQT kryen procedurat e marrjes së mostrave dhe të analizës së mallit dhe lëshon certifikatën përkatëse.

3.Organi tatimor dhe/ose doganor do të kryejë procedurat për lejimin e tregtimit dhe/ose zhdoganimit të lëndës djegëse për qëllime industriale dhe publike, me emërtimin e kodeve dhe cilësisë sipas pikës 1, pasi subjekti të paraqesë certifikatën e cilësisë së mallit të lëshuar nga IQT dhe konfirmimin për ngjyrosjen e tij sipas pikës 2.

4.Përfshihen nga zbatimi i këtij udhëzimi lëndët djegëse të kategorisë V, neni 10 i ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

5.Ky udhëzim hyn në fuqi 2(dy) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Dritan Prifti

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.212, datë 28.6.2010

**PËR MARRJEN DHE BASHKËRENDIMIN E MASAVE PËR GARANTIMIN E RENDIT
DHE RRIJTJEN E SIGURISË PUBLIKE, GJATË SEZONIT TURISTIK VEROR 2010**

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ligjit nr.10 220, datë 4.2.2010 “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë” dhe të vendimit nr.343, datë 12.5.2010 “Për mjetet motorike lundruese që lejohen të qarkullojnë në zbatim të moratoriumit “Për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, me qëllim krijimin dhe garantimin për pushuesit të kushteve sa më të mira të sigurisë, ambienteve e standardeve për pushime në zonat turistike dhe përmbushjen e objektivave nga ana e strukturave të Ministrisë së Brendshme, në qendër dhe në bazë për periudhën e sezonit turistik veror 2010

UDHËZOJ:

-Ngritjen e shtabeve të punës për marrjen dhe bashkërendimin e masave për garantimin e rendit dhe rritjen e sigurisë publike gjatë sezonit turistik veror 2010, në rang qarku, të kryesuar nga prefektët dhe me përbërje:

- Kryetarin e Këshillit të Qarkut
- Drejtorin e Policisë së Qarkut;
- Komandantin e Batalionit të Mbështetjes Rajonale;
- Kryetarin e Bashkisë/Komunës;
- Shefi i Njësisë Rajonale të Policisë Rrugore;
- Shefin e PMNZSH për qarkun;
- Përfaqësuesin e emergjencave civile në prefekturë;
- Drejtorin Rajonal të Shërbimit Parësor;
- Drejtorin Rajonal të Rrugëve.

- Hartimin dhe miratimin e një plani masash dhe plani veprimi, të detajuar sipas strukturave përkatëse, për zbatimin e detyrave të caktuara nga shtabi i punës, brenda datës 5.7.2010.

I.Strukturat e Policisë së Shtetit brenda datës 1 korrik 2010, të marrin këto masa:

1."Strukturat e Policisë së Shtetit, në përmbushje të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.362, datë 1.4.2009 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjet, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të marrin masa për lehtësimin e procedurave të hyrje-daljeve dhe qëndrimit të shtetasve të huaj në vendin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe ato të Policisë Rrugore të rrisin bashkëpunimin dhe intensifikojnë kontaktet me strukturat homologe policore të Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë dhe Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta për çështjet kufitare, parandalimin e trafikeve të paligjshme e qenieve njerëzore, kontrollin e përbashkët të akteve rrugore në të gjithë territorin e vendin me shërbimin policor të Kosovës, si dhe kontrollin e lëvizjeve të personave me precedentë policorë dhe penalë.

3.Në varësi të fluksit të udhëtarëve dhe mjeteve në POKK-të, drejtuesit e drejtorive rajonale të kufirit dhe migracionit të zhvillojnë takime dypalëshe me strukturat homologe të kufirit, me qëllim shtimin e sporteve për përbashkëpunimin dhe menaxhimin e fluksit dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin.

4.Të merren masat tekniko-logjistike për të siguruar gatishmërinë dhe funksionimin e plotë e të pandërprerë të gjithë sistemit TIMS dhe gjeneratorëve të furnizimit me energji elektrike të këtij sistemi, për të siguruar një veprimtari normale dhe pa pengesa në regjistrimin e udhëtarëve në pikat e kalimit kufitar.

5.Strukturat e varësisë së Ministrisë së Brendshme të bashkëpunojnë me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si dogana, fitosanitaret, roja bregdetare, kapiteneritë, autoritetet portuale, agjencitë private etj., me qëllim lehtësimin e procedurave të kalimit të shtetasve dhe mjeteve gjatë sezonit veror, nëpërmjet një kontrolli efikas të kufirit dhe pa e cenuar sigurinë.

6.Drejtuesit e strukturave qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, si dhe ata të shërbimit të kontrollit të brendshëm të raportojnë çdo njoftim, sinjalizim apo ankesë të shtetasve për rastet e abuzimeve me detyrën, shkeljeve të kërkesave të Kodit të Etikës së Policisë, keqsjelleve, keqtrajtimit apo shkelje të tjera të drejtave të qytetarëve nga ana e personelit policor, duke mbajtur qëndrim në përputhje me akte normative, deri në ndjekje penale.

7.Policia e Shtetit të intensifikojë masat në drejtim të rritjes së sigurisë në rrugë, parandalimit të aksidenteve dhe krijimin e kushteve për një lëvizje e qarkullim pa pengesa të mjeteve e këmbësorëve, sidomos në akset rrugore Durrës-Morinë, Durrës-Qafë Thanë, Durrës-Vlorë. Shkodër-Tiranë, Tiranë-Durrës, Kakavijë-Gjirokastër-Fier-Vlorë ose Durrës dhe Kapshticë-Korçë-Elbasan-Durrës.

8.Strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe ato të qeverisjes vendore të bashkëpunojnë për planifikimin dhe zbatimin e masave të përbashkëta për monitorimin e aktivitetit të lokaleve të natës, si disko, pube, duke evidentuar dhe moslejuar shkaktimin e zhurmave të cilat përbëjnë shqetësim për komunitetin etj.

9.Të bashkëpunojë ngushtë mes strukturave të linjës së Ministrisë së Brendshme me ato të Ministrisë së Punëve Publike e Transporte, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore,

sinjalistikës rrugore, rregullimin e manaxhimit e trafikut në qendrat urbane sipas akteve të pushtetit vendor, si dhe duke kufizuar gjatë periudhës së verës, në zona apo orare të caktuara lëvizjen e mjeteve të rënda.

10. Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit, në bashkëpunim me drejtoritë e policisë së qarkut dhe kapiteneritë e porteve të marrin masa për evidentimin, regjistrimin dhe pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm të gjithë motorëve të ujit.

11. Drejtuesit e njësisë të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Migracionit, të marrin masa për:

- përcaktimin e zonës ku motorët e ujit lejohet të përdoren sipas përcaktimit të vijës së plazheve publike dhe/ose private të vëna në dispozicion nga bashkitë dhe komunat;
- vendosjen e shenjave kufizuese (bovat) ku të përcaktohen vendvendosja, hyrja apo dalja dhe zona e lejuar e lundrimit për motorët e ujit;
- oraret e përdorimit;
- përcaktimi i distancës për të gjitha plazhet sipas pozicionit dhe thellësisë së ujit, e cila të jetë jo më e vogël se 100-300 metra (sipas thellësisë së ujit) dhe jo më larg se 1 milje nga bregu;
- për vendosjen e shenjave kufizuese të bashkëpunohet me shërbimin hidrografik shqiptar.

12. Njësi të patrullave të Policisë së Shtetit dhe asaj bashkiake nga toka dhe të Policisë Kufitare e Migracionit e rojes bregdetare nga deti të bëjnë kontrollin e motorëve të ujit për:

- mënyrën, kushtet dhe kriteret e përdorimit;
- lëvizjen brenda zonave të kufizuara;
- dokumentacionin e tyre;
- të mos lejojnë largimin dhe afrimin nga/në breg me shpejtësi më të madhe se 4 nyje;
- të mos lejohet afrimi i motorëve të ujit në një distancë më të vogël se 200 metra tek mjetet e tjera lundruese që janë në lundrim, në spirancë, në radat e porteve detare etj.

13. Drejtoritë e policëve në qarqe, drejtoritë rajonale të PKM-së dhe bashkitë ose komunat, të marrin të gjitha masat për të ndaluar plotësisht aktivitetin e motorëve të ujit deri në plotësimin e kriterëve të parashikuara në pikat 11 e 12 të këtij udhëzimi.

14. Të gjithë motorët e ujit, të cilët lëvizin pa u plotësuar kriteret e parashikuara në pikat 11 e 12 të këtij udhëzimi, duhet të bllokohen dhe sekuestrohen duke u konsideruar si aktivitet i jashtëligjshëm.

II. Kryetarët e bashkive dhe komunave dhe strukturat shtetërore në nivel vendor, në zbatim të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, brenda datës 1 korrik 2010, të marrin këto masa:

1. Kryetarët e bashkive dhe komunave:

- a) për pastrimin e plazhit nga mbeturinat dhe largimin e tyre;
- b) sigurimin e ujit të pijshëm;
- c) sigurimin e shërbimit shëndetësor 24 orë;
- d) eliminimin e zhurmave nga lokalet;
- e) të ndihmojnë për sigurimin e trafikuit në qarkullimin e makinave dhe njerëzve;
- f) sigurimin e shesheve për parkimin e automjeteve;
- g) për dhënien e lejeve dhe vendvendosjen e mjeteve motorike të ujit, si dhe kontrollin e qarkullimit të tyre në det.

2. Kryetarët e bashkive dhe komunave të ngarkojnë strukturat e policisë bashkiake të bashkëpunojnë me strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit, për përballimin e trafikut të automjeteve dhe zgjidhjen e çështjeve brenda kompetencave.

3. Kryetarët e bashkive dhe komunave të bashkëpunojnë me pronarët e hoteleve, restoranteve, lokaleve publike për të dhënë informacionin e nevojshëm për pushtuesit tek strukturat e policisë, për të rritur shkallën e sigurisë në zbatim të ligjit.

4. Kryetarët e bashkive dhe komunave që kanë në territorin e tyre plazhe, të krijojnë dhe të sigurojnë funksionimin e grupeve të dhënies së ndihmës së shpejtë përgjatë vijës së plazhit në rastet kur rrezikohet jeta e pushuesve nga mbytjet në ujë, rreziku nga zjarri apo aksidente të tjera. Në rrugët hyrëse të plazheve, të vendosen tabelat me numrat e telefonit të shërbimeve të Policisë së

Shtetit, të shërbimeve të emegjencës, të zjarrfikësve, grupeve të shpëtimit, si dhe tabela për zonat e rrezikshme për jetën.

5. Kryetarët e bashkive dhe komunave, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe rojen bregdetare, të marrin masa për zbatimin e kërkesave të këtij udhëzimi, duke caktuar vende të posaçme për motorët e ujit, si dhe kufizimet në det për lëvizjen e tyre.

6. Masat e marra gjatë këtij sezoni nga pushteti vendor dhe Policia e Shtetit të bëhen publike në mediat lokale apo kombëtare, duke kërkuar dhe bashkëpunimin e publikut për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

III. Ndjekja dhe raportimi

1. Prefektët evidentojnë dhe vlerësojnë informacionet ditore të dërguara nga kryetarët e bashkive dhe komunave, drejtoritë e policisë në qarqe dhe drejtuesit e strukturave shtetërore mbi zbatimin e planit të masave dhe planit të veprimit, si dhe të detyrave të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Prefekti i qarkut me cilësinë e kryetarit të shtabit të punës, merr informacion ditore nga strukturat e Policisë së Shtetit, të zgjedhurit vendorë, drejtuesit e strukturave shtetërore në nivel vendor dhe raporton çdo të premtë, me shkrim në Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit të masave dhe planit të veprimit, si dhe të detyrave të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen prefektët, shtabet e punës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

4. Ngarkohen zëvendësministrat e brendshëm për ndjekjen dhe monitorimin e këtij udhëzimi.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr.13, datë 15.6.2010

MBI DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR.6257, DATË 2.9.2008 “MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 7/1 bëhen këto ndryshime:

a) Shprehja “dhe që nuk janë verifikuar në terren nga Enti Kombëtar i Banesave” hiqet;

b) germa “a” ndryshon si vijon:

“Vërtetim negativ nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron banesë e regjistruar ose në proces regjistrimi”;

c) Germa “b”, ndryshon si vijon:

“Vërtetimin për përfitimin e statusit “banor në ish-pronë private”, miratuar me vendim të këshillit bashkiak, përpara vitit 2006”;

d) Në fund të fjalisë në gjuhën “c”, shtohet togfjalëshi “dhe atë aktuale”;

“7/2. Qytetarët të cilët nuk janë përfshirë në listat e dërguara nga bashkitë përkatëse, e respektivisht nuk kanë përfituar statutin me vendim të këshillit bashkiak, për t’u përfshirë në programin e kreditimit me interes 0% duhet që, përveç dokumentacionit të pikës 7.1 (a,c dhe d), të depozitojnë pranë zyrave përkatëse të EKB-së dokumentacionin shtesë të mëposhtëm:

a)Kopje të kontratës së qiramarrjes (me ish-ndërmarrjen komunale banesa) ose/autorizim apo vendim të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv (origjinale ose të noterizuara).

b)Vendim gjykate për kthim prone pronarit të ligjshëm, ose/dokument të lëshuar nga ish-NK Banesave për kalim prone në favor të pronarëve;/ose/vendim i kthimit të pronës nga Komisioni i Kthimit të Pronave pronarit të ligjshëm (origjinale ose të noterizuara)”.

3.Pas pikës 7/2 shtohen pikat 7/2/1, 7/2/2, 7/2/3 dhe 7/2/4, respektivisht me këtë përmbajtje:

“7/2/1 Përveç sa më sipër përfitojnë kredi me interes 0% edhe:

a) Familjet që kanë qenë qiramarrës në ish-pronë private, të cilët vazhdojnë të banojnë në po të njëjtën shtëpi pronar, por që për arsye ekonomike janë ndarë nga trugu familjar para vitit 1992;

b) Familjet që banojnë në banesat e emigrantëve politikë dhe ekonomikë;

c) Familjet qiramarrëse banuese në ish-pronë private në qiramarrje me pronarin, para vitit 1992.

7/2/2 Për familjet qiramarrëse në ish-pronë private, në të cilat njëri nga pjesëtarët e familjes së certifikatës së 1992 është shkëputur nga trugu familjar dhe ka përfituar pronë, struktura që do të përfitojë kjo familje të llogaritet vetëm për pjesëtarët e tjerë që mbeten në certifikatën e 1992.

7/2/3 Për familjet e divorcuara përfitojnë të dy familjet e krijuara mbas divorcit, por përllogaritja e përfitimit do të bëhet referuar certifikatës familjare të vitit 1992, duke pasur parasysh edhe ndarjen e familjes.

7/2/4 Enti Kombëtar i Banesave, në dosjet që krijon për çdo qytetar të përfshirë në pikën 7 të këtij udhëzimi, krahas dokumentacionit të pikave 7.1 dhe 7.2 të depozitohet edhe formularin e verifikimit në vend, të bërë nga komisionet e ngritura prej tij.

4.Pika 7/3 ndryshon si më poshtë:

“7/3 Listat e familjeve që përfshihen në pikën 7, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin e plotë dhe janë miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave për përfitimin e kredisë me interes 0%, i dërgohen nga ky i fundit bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Financave dhe MPPT. Pas konfirmimit nga banka për lidhjen e kontratave, EKB njofton menjëherë bashkitë respektive dhe pronarin e banesës”.

5.Pika 7/4 ndryshon si më poshtë:

“7/4 Listat do të përmbajnë emrin, atësinë, mbiemrin e kryefamiljarit, strukturën e apartamentit që përfiton, vlerën e kredisë që përfiton, sipas certifikatës familjare të muajit dhjetor 1992, e normave të strehimit referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 3.12.2004.”

6.Pika 8 ndryshon si vijon:

“8.Lista e familjeve që përfitojnë kredi me interes 3%, e miratuar me vendim të këshillit bashkiak, brenda kuotave që përcakton MPPT, bazuar në buxhetin vjetor, i dërgohet bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit. Format i listës emërore të hartohet nga njësitë vendore sipas formatit tip bashkëlidhur. Për llogaritjen e numrit të familjeve, për çdo bashki, që përfitojnë kredi me interes 3% MPPT bazohet në numrin total të përfituesve dhe në përqindjen që zënë aplikimet për strehim në një bashki në raport me totalin. Kjo ndarje përditësohet sa herë ka informacione nga bashkitë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të MPPT. Informacioni në faqen e internetit të MPPT përbën njoftim zyrtar dhe mund të përdoret nga bashkitë dhe banka e përzgjedhur”.

7. Pika 11 ndryshon si vijon:

“11.Për çdo qytet, kufiri maksimal i kreditimit për familje llogaritet sa 80% e vlerës së apartamentit të blerë në treg sipas çmimeve kufij që jepen në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Në rast se familja kërkon të kreditohet për një vlerë më të madhe, diferenca e kredisë paguhet me interesin e bankës. Të dhënat sipas tabelës nr.2 përditësohen çdo vit sipas vlerave të tregut të lirë të banesave që miratohen me udhëzimin e Këshillit të Ministrave dhe publikohen në faqen e internetit të MPPT”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Lidhja nr.2 – Formati i listës emërore

Nr. rendor	Emri/atësia /mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Statusi social i familjes	Statusi i punësimit të k/familjarit	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton	Të ardhurat mujore familjare të deklaruara	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9

Shënim.

- 1.Lista emërore duhet të jetë e shtypur (jo e shkruar me shkrim dore).
- 2.Çdo faqe e listës emërore duhet të ketë vulën e Këshillit Bashkiak.
- 3.Shkresa përcjellëse dërgohet me firmë të kryetarit të bashkisë në adresë të:
BKT, Banka Kombëtare Tregtare
Bulevardi “Zhan D’Ark”, Tiranë
- 4.Shkresa përcjellëse duhet të përmbajë numrin total të listës së familjeve që i dërgohen bankës si dhe faktin, nëse kjo është listë përfundimtare apo pjesore. Kopje e shkresës përcjellëse, pa listën emërore, i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
- 5.Në kolonën 2 vihet emri, emri i babait dhe mbiemri i kryefamiljarit.
- 6.Në kolonën 3 përbërja e familjes sipas certifikatës së gjendjes familjare.
- 7.Në kolonën 4 struktura e apartamentit që përfiton sipas normave të strehimit.
- 8.Në kolonën 5 me status social të familjes dhe/ose profesionin kuptohet (neni 5 i ligjit nr.9232, datë 13.5.2004):

- Familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar dhe ka në ngarkim fëmijë;
- individët me aftësi të kufizuara;
- familjet me shumë fëmijë;
- çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç;
- individët me statusin e jetimit.

Vini re! Përcaktimi i “pa strehë“, nuk është i vlefshëm.

9.Në kolonën 6 vendoset statusi i punësimit të kryefamiljarit ose personit që ka aplikuar si p.sh. punëtor, nëpunës, arsimtar, mjek, biznes i vogël etj.

10.Në kolonën 7 vendosen vlerat, sipas tabelës nr.2, për strukturën e apartamentit.

11. Në kolonën 8, vendosen të ardhurat mujore që ka deklaruar familja.

Qarku	Qarku Berat					Qarku Dibër					Q. Durrës	
	Berat	Çorovodë	Kuovë	Polliçan	Urë Vaigurore	Bulqizë	Burrel	Klos	Peshkopi	Durrësi	Fushe Krujë	
Nr. Rendor	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
vlerat e tregut të lire (viti 2010)	37,281	15,946	32,672	20,848	29,750	36,610	38,660	35,000	40,410	73,668	52,230	
G	1,565,802	669,732	1,372,224	875,616	1,249,500	1,537,620	1,548,120	1,470,000	1,697,220	3,108,656	2,193,660	
1+1	1,864,050	797,300	1,633,600	1,042,400	1,487,500	1,830,500	1,843,000	1,750,000	2,020,500	3,698,400	2,611,500	
2+1	2,311,422	988,852	2,025,664	1,292,578	1,944,500	2,268,820	2,285,320	2,170,000	2,505,420	4,596,016	3,238,260	
3+1	2,982,480	1,275,880	2,613,780	1,667,840	2,380,000	2,928,800	2,949,800	2,800,000	3,232,800	5,917,440	4,178,400	
Qarku	Krujë	Manzë	Sukth	Shijak	Belsh	Cerrik	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin	Prenjas	
Nr. Rendor	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	
vlerat e tregut të lire (viti 2010)	52,230		41,000	43,794	34,300	39,658	48,984	38,666	42,240	39,798	38,650	
G	2,193,660	0	1,722,000	1,839,348	1,440,800	1,665,636	2,057,328	1,623,972	1,774,080	1,671,432	1,623,300	
1+1	2,611,500	0	2,050,000	2,189,700	1,715,000	1,962,900	2,449,200	1,933,300	2,112,000	1,989,800	1,932,500	
2+1	3,238,260	0	2,542,000	2,715,228	2,128,800	2,458,796	3,037,008	2,397,262	2,618,980	2,467,352	2,396,300	
3+1	4,178,400	0	3,280,000	3,503,520	2,744,000	3,172,640	3,918,720	3,093,280	3,379,200	3,183,680	3,092,000	
Qarku	Ballsh	Divjakë	Fier	Lushnje	Patos	Roskovec	Gjirokastr	Kelcyre	Libohovë	Memaliaj	Përmet	
Nr. Rendor	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	
vlerat e tregut të lire (viti 2010)	34,800	46,671	56,094	41,202	31,892	36,772	48,035	23,250	29,400	9,340	27,456	
G	1,461,600	1,960,182	2,365,948	1,730,494	1,331,064	1,644,424	2,017,470	976,500	1,234,800	392,280	1,153,152	
1+1	1,740,000	2,333,550	2,804,700	2,060,100	1,594,800	1,838,600	2,401,750	1,162,500	1,470,000	467,000	1,372,800	
2+1	2,157,600	2,893,802	3,477,828	2,564,524	1,964,904	2,279,864	2,978,170	1,441,500	1,822,800	579,050	1,702,272	
3+1	2,784,000	3,733,880	4,487,520	3,296,160	2,535,360	2,941,760	3,842,800	1,890,000	2,352,000	747,200	2,196,480	
Qarku	Qarku Durrës	Qarku Elbasan	Qarku Fier	Qarku Gjirokastr	Qarku Shkëlzen	Qarku Tiranë	Qarku Vlorë	Qarku Durrës	Qarku Elbasan	Qarku Fier	Qarku Gjirokastr	

Qarku	Q. Gj.		Qarku Korçe										Qarku Kukës					Q. Lezhe			
	Tepelenë	Bilisht	Ersekë	Korçe	Leskovik	Maliq	Pogradec	B.Curri	Krume	Kukës	Lac	Korçe	37	38	39	40	41	42	43	44	
Bashkia																					
Nr. Rendor	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44										
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	20,260	35,680	24,959	45,500	20,243	29,406	56,094	27,300	27,060	34,030	40,552										
G	850,920	1,498,560	1,048,278	1,811,000	850,208	1,235,052	2,355,948	1,148,000	1,138,520	1,428,260	1,703,184										
1+1	1,013,000	1,784,000	1,247,950	2,275,000	1,012,150	1,470,300	2,804,700	1,385,000	1,353,000	1,701,500	2,027,800										
2+1	1,256,120	2,212,160	1,547,458	2,821,000	1,255,086	1,823,172	3,477,828	1,692,800	1,677,720	2,109,860	2,514,224										
3+1	1,620,800	2,854,400	1,966,720	3,640,000	1,619,440	2,352,480	4,457,520	2,184,000	2,164,800	2,722,400	3,244,160										
Qarku																					
Bashkia																					
Nr. Rendor	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55										
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	52,200	27,247	39,193	28,000	6,922	39,256	13,290	51,405	26,350	49,980	58,327										
G	2,182,400	1,144,374	1,646,106	1,176,000	290,724	1,648,752	558,180	2,159,010	1,106,700	2,088,160	2,449,734										
1+1	2,610,000	1,362,350	1,859,850	1,400,000	348,100	1,862,800	684,500	2,570,250	1,317,500	2,489,000	2,916,350										
2+1	3,238,400	1,688,314	2,429,988	1,736,000	428,184	2,433,872	823,980	3,187,110	1,633,700	3,088,760	3,616,274										
3+1	4,176,000	2,179,760	3,135,440	2,240,000	553,760	3,140,480	1,063,200	4,112,400	2,108,000	3,988,400	4,666,160										
Qarku																					
Bashkia																					
Nr. Rendor	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65											
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	37,000	50,000	84,750	39,800	53,400	34,170	48,600	49,500	25,200	59,101											
G	1,554,000	2,100,000	3,559,500	1,671,600	2,242,800	1,435,140	2,041,200	2,078,000	1,058,400	2,482,242											
1+1	1,850,000	2,500,000	4,237,500	1,990,000	2,670,000	1,708,500	2,430,000	2,475,000	1,280,000	2,955,050											
2+1	2,294,000	3,100,000	5,254,500	2,467,600	3,310,900	2,118,540	3,013,200	3,069,000	1,562,400	3,684,262											
3+1	2,960,000	4,000,000	6,780,000	3,184,000	4,272,000	2,733,800	3,888,000	3,960,000	2,016,000	4,728,080											
Qarku																					
Bashkia																					
Nr. Rendor	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65											
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	37,000	50,000	84,750	39,800	53,400	34,170	48,600	49,500	25,200	59,101											
G	1,554,000	2,100,000	3,559,500	1,671,600	2,242,800	1,435,140	2,041,200	2,078,000	1,058,400	2,482,242											
1+1	1,850,000	2,500,000	4,237,500	1,990,000	2,670,000	1,708,500	2,430,000	2,475,000	1,280,000	2,955,050											
2+1	2,294,000	3,100,000	5,254,500	2,467,600	3,310,900	2,118,540	3,013,200	3,069,000	1,562,400	3,684,262											
3+1	2,960,000	4,000,000	6,780,000	3,184,000	4,272,000	2,733,800	3,888,000	3,960,000	2,016,000	4,728,080											

UDHËZIM
Nr.20, datë 23.6.2010

PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË DETYRIMEVE TATIMORE PËR KATEGORITË E LOJËRAVE “BASTE SPORTIVE” DHE “BINGO”

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 61 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Për të gjitha subjektet, të cilat janë licencuar para hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, në kategoritë e lojërave “baste sportive” apo “bingo”, afati i vlefshmërisë së licencës së tyre, do të jetë afati i përcaktuar në çastin e lëshimit të licencës.

Këto subjekte duhet të paguajnë në organin tatimor “kuotën vjetore të ushtrimit të aktivitetit”. Kuota vjetore do të paguhet një herë në vit, sipas afateve të parashikuara në ligj, dhe sipas mënyrës së mëposhtme:

“Kuota vjetore e taksës për ushtrimin e aktivitetit” llogaritet si diferencë ndërmjet detyrimit vjetor për t’u paguar për ushtrimin e aktivitetit, sipas masës së parashikuar në ligj, me kuotat proporcionale respektive vjetore, të parapaguara dhe të paamortizuara.

“Kuota proporcionale respektive vjetore, e parapaguar dhe e paamortizuar” llogaritet si raport i shumës totale të parapaguar nga subjekti, në momentin e marrjes së licencës, me periudhën e vlefshmërisë së licencës, të përcaktuar në momentin e pajisjes me licencë.

Shembull: Subjekti “X” që operon në kategorinë “baste sportive” apo “bingo” është pajisur me licencë në vitin 2005, duke parapaguar detyrimin për pajisje me licencë, në shumën 10 000 000 lekë, për një afat 10-vjeçar.

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence do të skadojë në vitin 2015.

“Masa proporcionale respektive vjetore, e parapaguar, por e paamortizuar” llogaritet si më poshtë: $10\ 000\ 000:10=1\ 000\ 000$ lekë çdo vit, pra kjo licencë amortizohet çdo vit, në masën 1 000 000 lekë.

Në rast se sipas ligjit, detyrimi vjetor për ushtrimin e aktivitetit, për kategoritë e lojërave “baste sportive” apo “bingo” është 2 000 000 lekë në vit, për të llogaritur detyrimin për taksën e ushtrimit të aktivitetit të këtij subjekti, shumës 2 000 000 lekë do t’i zbritet kuota vjetore prej 1 000 000 lekë, e cila është parapaguar në momentin e marrjes së licencës.

Pra subjekti do të paguajë, për pjesën e mbetur të periudhës deri në përfundimin e afatit të licencës, diferencën prej 1 000 000 lekë.

3.Ky udhëzim është i zbatueshëm vetëm për ato subjekte, të cilat operojnë për lojërat “baste sportive” ose “bingo” dhe që janë pajisur me licencë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.21, datë 23.6.2010

**PËR KRITERET, MËNYRËN, MASËN DHE FORMËN E DËMSPËRBLIMIT PËR
SHOQËRITË TË CILAVE U ËSHTË REVOKUAR LICENCA PËR LOJËRA FATI**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 61 të ligjit nr.10 033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1.Të gjitha subjektet juridike apo fizike, të cilat janë pajisur me licencë nga autoriteti kompetent për të ushtruar aktivitete specifike për lojëra fati, të tilla si “lotari çasti”, “lotari me shorte”, keno etj., licenca e të cilave është revokuar me ligj të posaçëm, do të dëmshpërblehen nga organi tatimor, nën juridiksionin e të cilit ato janë të regjistruar.

2.Nuk përfitojnë nga ky udhëzim, ato subjekte të cilave u është revokuar licenca për arsye të shkeljes së dispozitave të ligjit apo të kushteve të përcaktuara në leje.

3.”Periudhë e përdorimit të licencës” konsiderohet periudha nga momenti i marrjes së saj e deri në momentin kur ka hyrë në fuqi ligji që ka revokuar licencën.

I.Kriteret për përfitimin e dëmshpërblimit

Dëmshpërblimi kryhet vetëm për ato subjekte, të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim. Për të përfituar dëmshpërblimin, subjektit të cilave u është revokuar licenca, duhet të depozitohen pranë drejtorisë rajonale tatimore, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë me shkrim, nënshkruar nga pronari i subjektit juridik/fzik apo administratorit të tij të deleguar, për kryerjen e rimbursimit. Kërkesa i drejtohet degës tatimore nën juridiksionin e së cilës subjekti është i regjistruar.

b) Dokumentin origjinal të licencës, lëshuar nga autoriteti përkatës.

c) Kopje e noterizuar e pasqyrave financiare, për periudhën e ushtrimit të aktivitetit të lojës së fatit, duke filluar nga viti kur subjekti është pajisur me licencë dhe deri në vitin kur është depozituar bilanci i fundit, që përfshin aktivitetin e lojës së fatit për të cilën është revokuar licenca.

II.Mënyra dhe forma e dëmshpërblimit:

1.Me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim, organi tatimor, pas verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit, përgatit dokumentacionin e nevojshëm për të kryer rimbursimin.

2.Nëse subjekti tatimpagues rezulton me detyrime të papaguara (përfshirë gjoba dhe kamatëvonesë) për aktivitetin për të cilin është revokuar licenca, vlera e detyrimeve i zbritet shumës për rimbursim.

3.Me kërkesën e subjektit, shuma për rimbursim mund të kalohet:

a)Në llogarinë e subjektit, të cilit i është revokuar licenca;

b)Për pagesën e detyrimeve për llogari të një subjekti tjetër, por me të njëjtin pronar/bashkëpronar. Në këtë rast, përfituesi detajon tek organi tatimor, me kërkesë, të gjitha të dhënat për destinimin e shumës për dëmshpërblim.

c)Për kryerjen e pagesave të ardhshme, nëse subjekti ka paraqitur/paraqet kërkesë pranë NJMLF-së për pajisje me licencë të re për lojëra fati. Në këtë rast, administrata tatimore dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, kryejnë procedurat e nevojshme për të realizuar transaksionin.

III.Masa e dëmshpërblimit

Përlogaritja e dëmshpërblimit bëhet, sipas formulës së mëposhtme:

Dëmshpërblimi = SH - (SH/N*n), ku:

SH-shuma e paguar në momentin e marrjes së licencës;

N-afati në muaj, i vlefshmërisë së përcaktuar në licencë;

n-periudha në muaj e përdorimit të licencës.

Shembull: Subjekti "X" është pajisur me licencë për ushtrim lojëra fati "Lotari me shorte" dhe ka paguar në momentin e marrjes së licencës, shumën 10 000 000 lekë, me afat vlefshmërie të licencës, 10 vjet.

Licenca është lëshuar në datën 10 korrik 2006. Në datën 15 janar 2009, ligji përkatës ka shfuqizuar këtë licencë. Masa e dëmshpërblimit që do të përfitojë subjekti, do të llogaritet si më poshtë:

Dëmshpërblimi lekë = 10 000 000 - (10 000 000/120 muaj*19 muaj).

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr.4288, datë 30.4.2010

PËR KONTROLLIN CILËSOR DHE SASIOR TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGSHME, TË GATSHME PËR TREGTIM, TË PRODHUARA NË RAFINERITË E NAFTËS DHE NË IMPIANTET E PRODHIMIT TË LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 22 dhe 24 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, të ligjit nr.9595, datë 27.7.2006 "Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik", dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 "Për akcizat", i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Kontrolli cilësor dhe sasior i nënprodukteve të naftës dhe i lëndëve djegëse të lëngshme të gatshme për tregtim, të prodhuara në rafineritë e naftës dhe në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme në Republikën e Shqipërisë, realizohet nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT), në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe nga strukturat përgjegjëse të organeve tatimore në varësi të Ministrisë së Financave.

2. Ndalohet tregtimi i nënprodukteve të naftës dhe i lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, të prodhuara në rafineritë e naftës dhe në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të cilat janë të pacertifikuara për cilësinë e tyre nga IQT dhe janë të pamonitoruara nga ana sasiore prej organeve tatimore.

3. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme janë të detyruara të deklarojnë paraprakisht në strukturat përgjegjëse të IQT-së dhe të organeve tatimore:

a) Llojet e nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, që janë të mundshme për t'u prodhuar në këto rafineri naftë ose në impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme.

b) Rezervuarët që do të përdoren për depozitimin e nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, të specifikuar sipas emërimit të projektit, llojit të produktit që depoziton dhe kapacitetit mbajtës të tyre.

4. Nuk lejohet depozitimi i nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, në rezervuarë të tjerë të cilët janë të padeklaruar në IQT dhe në organet tatimore.

Në rast të mosrespektimit të kësaj pike, organet tatimore zbatojnë penaltetet e nenit 40 dhe 41 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, në hyrje dhe dalje të çdo rezervuari të produkteve të gatshme për tregtim, të vendosin dhe të mbajnë përherë në funksion, aparate matës sasi të kontrolluara dhe certifikuara më parë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë i plumbos këto aparate, duke mbajtur për secilën dokumentacionin përkatës.

6. Furnizimi për depozitim i nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, nga rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, për në rezervuarët e tregtimit me nënprodukte të gatshme, të bëhet në prani të organeve fiskale dhe IQT, të cilat paraqiten me njoftimin e subjektit.

7. Organet fiskale dhe të Inspektoratit Qendror Teknik kontrollojnë përfundimin e furnizimit dhe depozitimit të secilit rezervuar me nënprodukte të gatshme nga rafineritë dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, dhe në prezencë të përfaqësuesve të këtyre subjekteve mbyllin saraçineskat e hyrjes dhe daljes së tyre, duke i plumbosur ato.

8. Inspektorati Qendror Teknik me njoftimin nga rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, në zbatim të procedurave ligjore dhe teknike, në prani të përfaqësuesit dhe subjektit, realizon marrjen e mostrës të nënproduktit të gatshëm të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, pasi ka verifikuar më parë dokumentacionin për furnizimin e rezervuarit dhe gjendjen teknike të tij.

Inspektorati Qendror Teknik kryen analizat për të vlerësuar standardin e cilësisë së nënprodukteve të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, dhe lëshon certifikatën përkatëse për cilësinë. Koha e kryerjes së analizave dhe e lëshimit të certifikatës, nuk mund të jetë më shumë se një ditë nga njoftimi që ka bërë subjekti.

9. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme e realizojnë tregtimin e produktit të gatshëm vetëm pas lëshimit të certifikatës nga ana e Inspektoratit Qendror Teknik dhe heqjes së plumbosjes së vendosur më parë nga organet përkatëse.

10. Për çdo rast shitjeje të nënprodukteve të naftës ose të lëndëve djegëse të lëngshme, të gatshme për tregtim, nga ana e rafinerive dhe impianteve të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, plotësohet dokumentacioni, faturë tatimore, certifikatë origjine, certifikatë cilësie, duke e shoqëruar edhe me mostër përfaqësuese të nënproduktit që tregtohet.

11. Rafineritë e naftës dhe impiantet e prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të krijojnë kushtet optimale për realizimin e kontroleve nga ana e strukturave shtetërore tatimore dhe të Inspektoratit Qendror Teknik.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, organet tatimore dhe Inspektorati Qendror Teknik të caktojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar pranë rafinerive të naftës dhe impianteve të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme, të cilat duhet të krijojnë kushtet e nevojshme me ambiente pune, për të lehtësuar procedurat e kontrollit sasior dhe të certifikimit cilësor të nënprodukteve të gatshme për tregtim.

13. Në rast shkelje të kërkesave të këtij urdhri, zbatohen sanksionet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për veprimtarinë përkatëse.

Ky urdhër hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
Dritan Prifti

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

NDREQJE GABIMI

Vendimi nr.366, i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Brendshme, në funksion të realizimit të një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptarë, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave” **është i datës 19.5.2010, dhe jo i datës 10.5.2010.**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 14.7.2010

Doli nga shtypi më 15.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë